



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Administrim Biznesi” me profile:

a. Menaxhim; b. Marketing; c. Kontabilitet & Financë

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Tirana Business University College”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Ingrid Shuli

2. Prof.As.Dr.Arlinda Ymeraj

Mars 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për Programin e studimit Bachelor në Adminstrim Biznesi, me profile:****a. Menaxhim; b. Marketing; c. Kontabilitet & Financë, ofruar nga****Tirana Business University College,**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Tirana Business University College
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Lëndëve të Përgjithëshme
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Adminstrim Biznesi, me profile: a. Menaxhim; b. Marketing; c. Kontabilitet & Financë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.794, datë 06.10.2010.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMASR Nr. 31, datë 25.30.2019 për programin e studimit të ciklit të parë BSC në "Adminstrim Biznesi" me profil " Marketing " UMASR Nr. 30, datë 25.03.2019 për programin e studimit të ciklit të parë BSC në "Adminstrim Biznesi" me profil " Menaxhim " UMASR Nr. 27, datë 25.03.2019 për programin e studimit të ciklit të parë BSC në "Adminstrim Biznesi" me profil " Kontabilitet Financë "
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMASh Nr. 326, datë 15.08.2013-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	30/14
18	Numri i studentëve: (2020-2021)	277 studentë
	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; 200 - 400 fjalë

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, me profile: a. Menaxhim; b. Marketing; c. Kontabilitet & Financë

Kolegji Universitar Tirana Business University College ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2010, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave, VKM nr.794, date 06.10.2010 “Për licensimin e Shkollës së Lartë Private “Kolegji Universitar TBU”. (Dokumenti 3 nga arshiva, VKM 794, date 06.10.2020) Sipas këtij vendimi SHLP “TBU”, organizohet në dy fakultete: Fakulteti i Administrim Biznesit dhe Fakulteti i të Drejtës së Biznesit.

Programi i studimit Bsc në Administrim Biznesi është hapur në vitin 2010, në bazë të VKM nr 794, date 06.10.2020. (Dokumenti 3 nga arshiva). Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Administrim Biznesit, Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, është i organizuar me kohë të plotë, në tre vite akademike dhe 180 ECTS. Sipas urdhërit të Ministrit në mbarim të programit të studimit lëshohet diploma “Bachelor”.

Programi i studimit Bsc në Administrim Biznesi, me profile: a. Menaxhim; b. Marketing; c. Kontabilitet & Financë është akredituar për herë të parë në vitin 2013 me Urdhërin Nr. 326, datë 15.08.2013 “Për akreditimin institucional dhe të disa programeve të studimit të Shkollës së Lartë Private “TBU”. Akreditimi është mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit, Nr. 506 datë 18.07.2013. Në këtë vendim jepet vlerësimi përfundimtar dhe rekomandimet për këtë program studimi.

Programi i studimit parashikohet të realizohet në 3075 orë gjithsej, nga të cilat 1575 orë janë orë studimi në auditor dhe 1500 orë janë orë studimi individual. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore. Në fund të vitit të tretë në planin mësimor të këtij program studimi, parashikohet të kryhet praktika mësimore me rreth 200 orë e 8 kredite (ETCS).

Qëllimi i këtij program studimi është të përgatisë specialistë në fushat e Administrim Biznesit dhe Menaxhimit, të profilizuar në specialistë administrim biznesi dhe specialistë menaxhimit, të pajisur me njohuri bashkëkohore teorike dhe shprehi të duhura praktike, për t’u përgjigjur kërkesave të tregut, të biznesit për këto profile. Aktualisht në këtë program studimi janë të regjistruar dhe vazhdojnë studimet 277 studentë. Politika e TBU për punësimin e studentëve, ka bere qe 80% e tyre te jenë të punësuar që në vitin e pare Bachelor.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, me profile: a. Menaxhim; b. Marketing; c. Kontabilitet & Financë ofruar nga Fakulteti i Administrim Biznesit, Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, pranë Institucionit të Arsimit të Lartë Tirana Business University College filloi me trajnimin pranë ASCAL, marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga TBU-ja, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Ingrid Shuli dhe Prof.Asoc. Arlinda Ymeraj. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga Kordinatore Teknike e ASCAL, Znj.Juna Mengri.

Në bashkëpunim dhe me kordinatoren teknike të ASCAL u caktuan datat e vizitës në institucion si dhe u përgatit axhenda e takimeve që do të realizoheshin. Axhenda iu dërgua paraprakisht edhe institucionit. Përpara vizitës në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi një takim me kordinatorin e ASCAL, ku u diskutuan elementë të vlerësimit të programit.

Vizita dy ditore në institucion u zhvillua në datat 24 dhe 25 Shtator 2020. Gjatë kësaj vizite, GVJ u takua me: Drejtues te TBU, Dekanin e Fakultetit të Administrim Biznesit dhe Përgjegjës te Departamenteve; grupin e vlerësimit të brendshëm; pedagogët e aktivizuar në këtë program studimi; studentë të këtij programi studimi, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të zyrës së Kurrikulës, përfaqësues të zyrës së Projekteve, përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të zyrës së Shërbimit të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u vizituan ambjentet e institucionit ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, si edhe ambjentet e bibliotekës.

Pas vizitës në Institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm diskutoi për çështje dhe problematika që dolën gjatë shqyrtimit dhe analizës të materialeve të paraqitura nga institucioni, diskutimeve gjatë ditëve të takimit, si dhe shqyrtimit dhe analizës së materialeve shtesë që iu kërkuar institucionit në ditën e dytë të vizitës. Më tej ky grup filloi punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm.

Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft raportin tek koordinatori teknik i ASCAL.

Më datë 28.01. 2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 5/6 Prot., datë 02.02.2021, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, më datë 03.02.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 21/4/2 Prot., datë 03.02.2021, përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. GVJ, pasi shqyrtoi me seriozitet komentet e IAL, shprehet si vijon:



GVJ, pasi u njoh me komentet e TBU, gjykon se në përgjithëse këto komente nuk janë të mbështetura në të dhëna dhe as në evidenca, ndërsa GVJ ka analizuar të gjithë veprimtarinë e institucionit me kujdes, përkushtim, seriozitet si edhe objektivitet.

GVJ rikonfirmon edhe një herë të gjithë konsideratën për veprimtarinë e institucionit si në drejtim të zbatimit të programit akademik ashtu edhe në drejtim të ruajtjes së cilësisë. GVJ është plotësisht e bindur se TBU, në sajë të investimit të ekipit akademik dhe mbështetës ka krijuar reputacion të admirueshëm jo vetëm në tregun shqiptar të arsimit të lartë privat, por edhe në rajon.

Pavarësisht vlerësimeve tepër të larta, të detajuara edhe në raportin e Vlerësimit të Jashtëm, GVJ gjykon që gjithmonë ka vend për përmirësime. Për rrjedhojë, GVJ sqaron si më poshtë:

1.Rekomandimi 2 i GVJ: Të krijohet akses në librari elektornike si dhe të pasurohet më tej biblioteka me botime të printuara.

Komenti i TBU: TBU shpjegon rëndësinë e bibliotekës si edhe vëmëndjen që i është kushtuar nga TBU, duke shprehur mos pranimin e rekomandimit të GVJ

GVJ: GVJ vlerëson angazhimin e strukturave përkatëse për pasurimin dhe zhvillimin e bibliotekës. Sidoqoftë, nuk gjen argumenta dhe evidenca në komentin e TBU, për rrjedhojë rekomandimi dhe vlerësimi mbeten siç janë.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

2.Rekomandimi 3: Të publikohen vlerësimet lidhur me procesin e sigurimit të cilësisë.

Komenti i TBU: TBU vetëm shpjegon se ka gjykuar që raporti i detajuar i përgatitur është mëse i mjaftueshëm për palët e treta, ndonëse nuk e kundërshton rekomandimin e GVJ për publikimin e vlerësimeve me qëllim aksesimin e tyre. Mbi këtë arsyetim, TBU kërkon rishikimin e vlerësimit.

GVJ: GVJ gjykon që analiza e kriterit është bërë me përgjegjësi dhe dashamirësi, për rrjedhojë konkludon që vlerësimi mbetet i pandryshuar.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

3.Komenti TBU në lidhje me fushën 2, standarti II.3 dhe II.5: TBU nuk pranon vlerësimin “Përmbushet kryesisht” duke gjykuar se është më pranë vlerësimit “Përmbushet plotësisht”.

GVJ: Duke rikonfirmuar të gjithë konsideratën për veprimtarinë akademike të institucionit të vlerësuar, GVJ konstaton se pavarësisht mospranimit të vlerësimit, TBU nuk sjell evidenca të reja të paparaqitura më parë gjatë vizitës në institucion. Pavarësisht mos pranimit, GVJ nuk konstaton argumenta bindëse, për rrjedhojë mbetet me vlerësimin e mëparshëm.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimi i parë: Të bëhen përpjekje për të plotësuar kriterin për titullarë me gradë “Doktor” apo titull “Docent”, për rreth 20% të lëndëve të ofruara në programin e studimit.

Ne TBU i gjithë stafi akademik i këtij program studimi ka të paktën kualifikimin Master i Shkencave në fushën e përgjithëshme dhe specifike, për të cilën është i përfshirë dhe ka kompetencë dhe përvojë në mësimdhënie. Në këtë program studimi që mbulohet nga **Departamenti i Lëndëve të përgjithëshme** zhvillojnë mësim **13 personel akademik efektiv (PAE)**, nga këta **1 Prof.As, 2 me gradë Doktor, 1 në proces doktorature** dhe 9 me diplomë Master i Shkencave (Msc).

Ne lidhje me kete rekomandim, GVJ vlereson se stafi akademik i angazhuar ne programin bachelor i ploteson kriteret e kualifikimit.

GVJ shprehet se rekomandimi është plotësuar tërësisht.

Rekomandimi i dytë: Të krijohet akses në librari elektronike, si dhe të pasurohet më tej biblioteka me botime të printuara.

Nga Tetori 2014 e në vazhdim TBU është e abonuar në bibliotekën elektronike EBSCO. Pjesa e dytë e rekomandimit është lidhur me plotësimin e bibliotekës me botime të printuara (Standarti III.3, kriteri 4,5).

Për sa më sipër, GVJ është e mendimit, se institucioni nuk e ka plotësuar ende kete rekomandim, prandaj i sugjeron TBU qe duhet të ndërmarrë iniciativa për shtimin e titujve për literaturën bazë dhe ndihmëse, periodikëve, revistave në hard copy.

GVJ shprehet se rekomandimi është plotësuar kryesisht.

Rekomandimi i tretë: Të publikohen vlerësimet, lidhur me procesin e sigurimit të cilësisë.

Në TBU funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ben monitorim të vazhdueshem për këtë program studimi për të verifikuar plotësimin e standardeve te cilësisë ashtu si janë të përcaktuara në Kodin e Cilësisë.

NJBSC kryen vlerësime për mësimdhënien, vlerësime për kurrikulën etj, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni si edhe nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të NJBSC, nuk evidentoi asnjë raport në lidhje më vlerësimet e tjera përveç pyetësorëve ndaj studentëve dhe stafit akademik. I vetmi raport i publikuar nga TBU në faqen e website-it është Raporti Vjetor.

GVJ shprehet se rekomandimi është plotësuar kryesisht.



Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Administrim Biznesi

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Sipas vizites në institucion, dokumentave në sistem rezulton se TBU ka filluar të ushtrojë veprimtarinë akademike me VKM Nr.794, datë 06.10.2010, me Urdhër të MASH Nr.75, datw 16.02.2011 si dhe vendim të akreditimit institucional dhe të secilit program studimi me Urdher të MASH nr 326, datë 15.08.2013, i paraprirë prej Vendimit nr 506, datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Larte.</p> <p>Misioni i TBU për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi është ofrimi i arsimimit gjithëpërfshirës për studentët që përzgjedhin këtë program, ofrimi i kualifikimit dhe i ndjekjes së veprimtarive të tjera të lidhura me punësimin.</p> <p>Vizioni i TBU është promovimi i vlerave kombëtare përmes ofrimit të edukimit/arsimimit me qëllim nxitjen e respektimit të etikës qytetare, të profesionalizmit, nxitjen e respektimit të kodeve të sjelljes, me synim formimin e njëe qytetarie model për konsolidimin e vlerave dhe interesave kombëtare në fushën e arsimit.</p> <p>TBU ofron programe studimi në përputhje me politikat kombëtare, duke përgatitur specialiste të aftë për sipërmarrje, inovacion, duke mundësuar dhe punësimin në përgjigje të interesave kombëtare.</p> <p><u><i>Aneksi 3.1 TBU strategjia e zhvillimit 2018:</i></u> <u><i>Aneksi Vendim i akreditimit institucional:</i></u> <u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</i></u></p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Nisur nga RVB-ja dhe dokumentacioni që është përcjellë nga IAL, DVV, Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile: a. Menaxhim; b. Marketing; c. Kontabilitet & Financë është në përputhje me synimet dhe misionin e institucionit sipas statutit dhe strategjisë së TBU. Misioni i institucionit konsiston në edukimin e studentëve në fushën e ekonomisë duke u mbështetur në programe bashkëkohore studimi, në kërkimin shkencor, në vënien në praktikë të dijeve të marra nga studentët në bizneset private, pranë institucioneve publike, etj. TBU ka në themel të punës përgatitjen profesionale</p>



	<p>të studentëve, duke i vënë rëndësi rritjes së cilësisë, përpjekjes për të siguruar formimin si nga pikpamja teorike dhe praktike, duke i dhënë prioritet fushave të biznesit. Në hartimin e programeve të studimit objektiv është konsolidimi i vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p><u><i>Aneksi 2 TBU statuti;</i></u> <u><i>Aneksi 3.1. Strategjia e zhvillimit TBU 2018-2024;</i></u> <u><i>0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</i></u></p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi është me tre profile: Manaxhim; Kontabilitet-Finance; Marketing. Sipas vizites në institucion, dhe dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, qëllimi i ndarjes në tre profile të këtij programi studimi është përgjigja kërkesave të tregut për specialistë të këtyre profileve, të cilët pajisen me njohuri teorike e praktike specifike, duke i aftësuar studentët të kuptojnë kërkesat, kushtet e tregut, konkurrencën, mjedisin ekonomik, ligjor e social ku operon biznesi.</p> <p><u><i>Aneksi 2 TBU statuti;</i></u> <u><i>Aneksi 3.1. Strategjia e zhvillimit TBU 2018-2024;</i></u> <u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</i></u></p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstatoi që KU TBU ka përcaktuar qartë në rregulloren e Programit të Studimit dijet, aftësitë dhe kompetencat që duhet të fitojnë studentët në përfundim të Programit të Studimit. Hartimi i Programit të Studimit është mbështetur kryesisht në partneritetin e departamentit me komunitetin e biznesit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, me institucione bankare dhe financiare.</p> <p>Programi i Studimit është hartuar duke mbajtur parasysh kryesisht nevojat e tregut vendas, i nxitur nga zhvillimet ekonomike në vend.</p> <p><u><i>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab</i></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>




Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar dokumentit Strategjia e Zhvillimit të TBU për vitet 2018-2024, RVB-së dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi që hartimi dhe përditësimi i Programit të Studimit mbështetet gjate realizimit të tij -në strategjinë për zhvillimin e institucionit. <i>Aneksi 3.1 TBU strategjia e zhvillimit 2018;</i> <i>0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</i>			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Sipas RVB, informacionit të marrë në institucion, ky program studimi i bazuar në Statutin dhe në Rregulloren e institucionit, të gjitha ciklet e studimit që ofrohen nga TBU, së bashku me elementet e programeve të studimit përshkruhen në statut. <i>Aneksi 2 TBU statuti;</i> <i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</i> <i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</i>			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi i programit të studimit i referohet dhe është i lidhur drejtpërdrejt me fushat që ka vendosur ndër prioritetet e tij TBU, bazuar në Statutin dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi VKM nr 41, datë 24.01.2018. Programi i studimit përbëhet nga elementët mësimorë si lëndët, modulet, praktika mësimore, diploma, të cilat formojnë studentët si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga ajo praktike në fushën e administrimit biznesit, kontabilitetit e financës edhe nga ajo e marketingut. <i>Aneksi 2 TBU statuti</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për	Objektivat e këtij Programi studimi Bachelor në Administrim Biznesi, janë paraqitur në Rregulloren e këtij programi dhe mund të përmbledhen në: Pajisjen e studentëve me njohuritë

<p>formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>bazë dhe të avancuara për administrimin e biznesit. Njohuritë e fituara nga studentët lidhen me eksperiencat më të mira të fushës dhe të përshtatura për kushtet e ekonomisë shqiptare. Këto njohuri të marra do shërbejnë si bazë për studentët për të vazhduar më tej studimet pasuniversitare, nëse studentët e dëshirojnë këtë. Studenti duhet të jetë i aftë të përshtatet me tregun e punës e të përgatitet me ambicie për të ecur e për t'Ë zhvilluar në karriere. Përmes kryerjes praktikave mesimore, njohjes me praktikën e eksperiencat e bizneseve të ndryshme me të cilat ka marrëveshje IAL TBU dhe më tej punësimit në këto biznese.</p> <p>Sipas dokumentave të TBU rezulton se TBU ka si objektiv kryesor që studentët e këtij program studimi të punësohen në pozicione pune që kanë lidhje me profilin e studimeve para përfundimit të vitit të tretë bachelor, qoftë brenda apo edhe jashtë vendit.</p> <p><u><i>Aneksi 7 Rregullore e programit të studimit bachelor AB;</i></u> <u><i>Aneksi 14 Dosja e plotë e programit të studimit me elementet perberes te tij.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Para hapjes si IAL të TBU është zhvilluar një analizë e tregut të punës, për t'Ë përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës me ofertën e tij. Ky studim i tregut të punës i ka ndihmuar të marrin mundësitë që ofrojnë bizneset e sektoreve të ndryshëm për punësim, nevojat e tyre për specialistë të profileve të ndryshme, me qëllim që universiteti të ndërtojë profilet e veta të programeve të studimit. Duke njohur zhvillimet aktuale dhe të perspektivës TBU plotësoi nevojat e tij me staf akademik të përgatitur, të cilët në pjesën më të madhe kanë eksperiencë të mira edhe në institucionë financiare, në biznese, po kështu TBU bën përzgjedhjen e studentëve përmes konkurseve, zhvillon mësimin me programe bashkëkohore, lidh çështjet teorike me praktikën e bizneseve, ndjek Alumni në karrierën e tyre. TBU vazhdon në mënyrë periodike të studiojë tregun e punës për të ndjekur punësimin e karrierën e studentëve edhe pas mbarimit të studimeve në TBU.</p> <p><u><i>Aneksi 16 Analiza e tregut të punës para hapjes së programit;</i></u> <u><i>Aneksi 17 Studimi për tregun e punës, Janar 2020</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënësve,</p>	<p>Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit Bachelor në Administrim Biznesi janë në përputhje me objektivin kryesor të Strategjisë së Zhvillimit të TBU: “të paktën 75% të studentëve Bachelor të jenë të punësuar në profil përpara diplomimit”. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe</p>




<p>garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>vizitës në IAL, konstatoam se në planin mesimor, ka një vend të caktuar praktika mësimore, me kreditet përkatëse, po kështu në kurrikulat e lëndëve, saktësohen rezultatet e pritëshme të të nxëniet nga ana e studentëve. Njohuritë e marra në çdo lëndë të profilit të zgjedhur, i pajisin studentët me kompetencat e duhura dhe i përgatisin për veçoritë e tregut të punës. Studentët e TBU përfshihen në punë të kontraktuara me pagese në biznese të sektoreve të ndryshem, orari i mësimit u përshtatet me orarin e punës, pa cënuar zhvillimin e pragramit mësimor.</p> <p>Pas takimit më zyrën për çështjet studentore e zhvillimin e karrieres, u njohëm me aktivitetin e kësaj zyre, e cila ka si funksion kryesor komunikimin me bizneset që janë partnere e kanë marrëveshje me TBU, për të marre informacion për pozicionet e lira të punës, dhe për t’ia komunikuar këtë information studentëve, e për të mundësuar punësimin e tyre gjatë periudhës së studimeve në bachelor. Në këtë mënyrë është arritur edhe objektivi i vendosur në objektivet formues të TBU.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga TBU janë organizuar në përputhje me VKM nr 41, datë 24.01.2018 dhe harmonizojnë të gjithë elementët përbërës të tyre: lëndët bazë, lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore; lëndët me zgjedhje; dhe praktiken mësimore profesionale.</p> <p><u><i>Aneksi3.1 TBU strategjia e zhvillimit 2018;</i></u> <u><i>Aneksi 12 Rregullore Zyra e Karrieres TBU.pdf</i></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>GVJ, i është referuar RVB, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, Marrëveshjes midis TBU dhe MASR për personelin akademik me kohë të plotë, sipas së cilës TBU përjashtohet nga detyrimi ligjor për të patur minimalisht 7 anëtarë në departament. GVJ vlerëson se TBU ka përzgjedhur stafin akademik të brendshëm dhe të ftuar duke respektuar kriteret ligjore për titujt dhe gradat për çdo departament dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-4342

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>sipas cikleve të studimit. Një pjesë e stafit akademik ka kryer studime universitare ose pas universitare brenda e jashtë vendit. Kjo u verifikua edhe me shqyrtimin e CV-ve të pedagogëve. Rezultoi se pedagogët e TBU, përveç eksperiencës akademike kanë edhe eksperiencë të pasur praktike, lidhje me institucione apo rrethe profesionale, si dhe kanë kryer kualifikime apo trainime të vërtetuara me certifikata profesionale.</p> <p>Sipas diskutimeve në TBU me pedagogët, por edhe sipas dokumentacionit, rezulton se një lëndë e caktuar zhvillohet nga ekip pedagogësh i përbërë nga lektori, bashkëlektori, pedagogu i seminarit, si dhe të ftuar specialë me eksperiencë nga praktika që sjell ekspertizën e tij në auditor, që mund të zhvillojë tema të caktuara për një lëndë. Numri i studentëve në vit është rreth 100, aktualisht në TBU jane rreth 480 studentë. Numri i pedagogëve për student është 1:15 për vitin akademik 2019-2020 për Fakultetin e Administrim Biznesit. Ky është një tregues i kapaciteteve që ka TBU për arritjen e objektivëve në këtë program studimi.</p> <p><u><i>Aneksi 06 Marrëveshja mes TBU dhe MASR për përcaktimin e numrit të personelit akademik me kohë të plotë, në njesitë bazë, në Kolegjin Universitar “Tirana Business University”;</i></u> <u><i>Aneks 20 CV Stafit Akademik Programi Bch AB</i></u> <u><i>Aneksi 23 Te dhena Tabelore pers.akad. njesia kryesore&njesia pergjegjese</i></u> <u><i>Aneksi 24 Të dhëna tabelore personeli akademik i programit</i></u> <u><i>Aneksi 25 Të dhëna tabelore ngarkesa e plote stafi akademik</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, vlerëson se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Administrim Biznesit.</p> <p><u><i>Aneksi 7 Rregullore e programit të studimit bachelor AB;</i></u> <u><i>Aneksi 14 Dosja e plote e programit te studimit me elementet perberes te tij.pdf;</i></u> <u><i>0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf]</i></u></p>




<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Referuar RVB, dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, pra të Departamentit të Lëndëve të Përgjithshme, përgjegjës për programin e studimit. Stafit i departamentit, i cili rezulton se është plotësuar me personel akademik të brendshëm, efektiv, duke përmbytur dhe një nga rekomandimet e lëna nga akreditimi i kaluar, angazhohet për të mbuluar të gjitha lëndët e planit mësimor. Ka lëndë që zhvillohen edhe nga pedagogë të departamenteve të tjera, kur bëhet fjalë për lëndë specifike, apo për lëndë të trungut, të dy viteve të para, në të cilat studentët zhvillojnë të njejtat lëndë.</p> <p><u>Aneksi 23 Të dhëna Tabelore pers.akad. njësia kryesore & njësia përgjegjëse:</u></p> <p><u>Aneksi 25 Të dhëna tabelore ngarkesa e plotë stafi akademik</u></p>			
<p>Shkalla e përmbyshjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbyshet</p>	<p>Përmbyshet pjesërisht</p>	<p>Përmbyshet kryesisht</p>	<p>Përmbyshet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se Fakulteti i Administrimit Biznesit në TBU ka në organigramën e vet tre departamente, apo njësi bazë: Departamenti i Manaxhimit, Departamenti i Kontabilitet-Financës dhe Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme. Për këtë program studimi, pra për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi, njësia bazë përgjegjëse është Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, i cili mbështetet nga Departamenti i Manaxhimit për lëndë specifike të Manaxhimit dhe Marketingut dhe nga Departamenti i Kontabilitet - Financës për lëndë specifike të Kontabilitetit dhe Financës.</p> <p>Njësitë bazë apo departamentet referuar informacionit të marrë në institucion, funksionojnë sipas statutit dhe të gjitha rregulloreve të TBU. Për përmirësimet që i bëhen kurrikulës apo programeve të</p>




	<p>lëndëve, diskutimi e propozimi bëhet nga njesia bazë dhe më pas ndjek hierarkinë e vendimmarrjes deri në Senat Akademik. Brenda departamentit bëhet analiza periodike e punës së stafit akademik, nëpërmjet matjes së performancës së mësimdhënies dhe rezultateve të studentëve për cdo semester, dhe vjetore. Këto analiza bëhen pjesë e Raporteve Vjetore të TBU, dhe publikohen në faqen e ëeb të TBU</p> <p><u><i>Aneksi 2 TBU statuti;</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</i></u> <u><i>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU’;</i></u> <u><i>Aneksi 52 Procedura per ndryshimin e kurrikules]</i></u> <u><i>Aneksi 38 Analize e realizimit të objektivave Programi Studimit BachelorAb 18-19</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se TBU ka marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete brenda vendit, dhe me disa universitete jo publike, në të cilat ka edhe pjesëmarrje në konferencën e Rektorëve.</p> <p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se Fakulteti i Administrim Biznesit në TBU ka bashkëpunime edhe me institucione të arsimit të larte jashtë vendit, si me Universitetin Staffordshire, në Mbretërinë e Bashkuar, në kuadrin e projekteve Erasmus + KAI ICM, dy prej tyre janë realizuar në periudhën 2017-2020 dhe projekti tjetër pritet të zbatohet deri në fund të vitit akademik 2020- 2021. Rreth 12 personel akademik nga departamentet e këtij IAL kanë patur shkëmbime eksperience në kete universitet. Është kryer nga TBU dhe analiza rreth perfitimeve të stafit akademik dhe të TBU nga këto shkëmbime. Rezulton se TBU ka bashkëpunime me një numer organizatash biznesi, rreth 120, përmes të cilave mundëson praktikant mësimor të studentëve, disa prej të cilave finalizohen me punësim të tyre.</p> <p><u><i>Aneksi 34 TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme;</i></u> <u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare web (link 29);</i></u> <u><i>Aneks shtese 02 IIA TBU Staffordshire University 2017;</i></u> <u><i>Aneks shtese 03 IIA TBU Staffordshire University 2018;</i></u> <u><i>Aneksi 34 TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme</i></u></p>




<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga takimi në IAL, rezulton se departamentet si njësi përgjegjëse për programin e studimit raportojnë përmes analizave të punës mësimore e kërkimore për realizimin e gjithë elementeve të programit të studimit, të praktikave mësimore, të internship-eve dhe të realizimit të objektivave rreth punësimit të studentëve. Këto njësi përgjegjëse analizojnë edhe përfitimet që i vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit me biznese, institucione financiare, arsimore etj.</p> <p><u>Aneksi 34 TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme.pdf;</u> <u>Aneksi 35 Raporti periodik perfitimi marreveshje bashkepunimi.pdf</u> <u>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare web (Link 9)</u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>TBU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me biznese, për kryerjen e praktikave mësimore, për vendosjen e një mbikëqyrësi praktike, i cili bën edhe vlerësimin e punës së studentit, vlerësim ky që i bashkëngjitet vlerësimit të pedagogut udhëheqës, deri në mbrojtjen para komisionit të praktikës mësimore. Sigurohet vend praktikë në varesi të natyrës specifike të programit të studimit. TBU rezulton se ka kontakte të vazhdueshme me bizneset me të cilat ka marrëveshje jo vetëm për praktikatat e studentëve, por edhe për trainime profesionale të stafit të këtyre bizneseve apo për shkëmbim eksperiencë në auditore nga drejtuesit e këtyre bizneseve.</p> <p><u>Aneksi shtese nr 18 Rregullore e praktikës mesimore;</u> <u>Aneksi 34 TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme.pdf;</u> <u>Aneksi 35 Raporti periodik perfitimi marreveshje bashkepunimi.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Rezulton se TBU organizon aktivitete profesionale, si takime e seminare të hapura me specialistë, lektorë të fushave të ndryshme nga universitete brenda e jashtë vendit, por edhe nga përfaqësues të bizneseve apo institucioneve vendimarrës brenda vendit. Studentët bëhen pjesë e këtyre takimeve, ku ftohen edhe studentë Alumni, duke mbajtur lidhje të vazhdueshme me ta.</p> <p>Ky informacion u mor nga takimi me drejtuesit, pedagogët dhe studentët në institucion dhe konsiderohej një pikë e fortë në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>




	Por gjithësi në RVB si edhe gjatë takimit që GVJ pati në institucion nuk evidentoi asnjë evidencë apo dokumentacion në lidhje me këtë kriter. <i>Aneksi 47 Të dhëna nga faqja zyrtare ëeb.pdf (Link 1)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se Fakulteti i Administrim Biznesit në TBU e ka hartuar programin e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi, LAL 80/2015 dhe VKM nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Struktura e këtij programi paraqitet në Rregulloren e tij Për secilin profil, lëndët paraqiten të ndara në orë leksioni, seminari, laboratore, dhe në kredite (ETCS) për secilën prej tyre, janë përcaktuar edhe orë individuale të punës së studentit. Cdo vit ka jo më pak se 60 kredite e në fund të tre viteve studenti duhet të ketë grumbulluar 180 kredite. <i>Aneksi 7 Rregullore e programit studimit Bachelor Administrim Biznesi.;</i> <i>Aneksi 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.pdf</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e	Qëllimi i programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi është të përgatisë administratorë të pergjithshëm, manaxherë, si dhe administrator sipas profileve të vecanta për marketing, për

<p>shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>financë e kontabilitet, të pajisur me njohuri teorike e përgatitje praktike për t'u përshtatur sa më mirë kërkesave e nevojave të tregut, të mjedisit ekonomik në të cilin operon biznesi, të mësojnë përmes rasteve studimore e t'ij praktikojnë ato. Sipas vizitës në institucion, konstatohet se struktura e programit të studimit, e ndarë sipas profileve, përfaqëson në vetvete një kombinim mes lëndëve karakterizuese të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe lëndëve karakterizuese të profilit specifik si: Manaxhim; Kontabilitet – Financë dhe Marketing.</p> <p><u><i>Aneksi 7, Rregullore e programit studimit, neni 5</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Referuar dokumentave të marra në IAL, referuar strukturës së programit përmendur në kriterin 2, studentët përfitojnë njohuri të përparuar në lëndët që përfshihen në Programin e studimit Administrim Biznesi si në lëndët: Manaxhim Projektesh, Vlerësim Projektesh, Qeverisje Korporatash, si dhe njohuri të përparuar në nivel të profilit specifik si psh.: Manaxhim i Marrëdhënieve me Klientët, Tregje e Institucione Financiare, Biznes Ndërkombëtar, Marketing Ndërkombëtar, Manaxhim Strategjik i Markës etj.</p> <p><u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare web.pdf.</i></u> <u><i>Link 17 Programet mesimore</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi, në dy vitet e para përmban lëndë baze, ndërsa vitin e tretë të studimit u jepet mundësi studentëve të zgjedhin profilet ku ndihen më mirë, duke përzgjedhur edhe lëndët me afër profilit të tyre, për të fituar jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike dhe kompetenca të avancuara, të cilat i realizojnë përmes detyrave apo projekteve specifike në secilen lëndë. Kapacitetet njerëzore të njesive bazë në TBU, disponojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të cilat ua transmetojnë studentëve për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme.</p> <p><u><i>Aneksi 19 Syllabusët e lëndëve.</i></u> <u><i>Aneksi 23 Te dhena Tabelore personeli akademik. njesia kryesore & njesia përgjegjëse</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë</p>	<p>Konstatohet nga dokumentat dhe nga çfarë u përmend në Kriterin 1 të këtij standardi, se struktura e këtij program studimi është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi dhe me VKM në 41, datë 24.01.2018 në vecanti. Studenti në përfundim të ciklit të parë</p>




<p>strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>të studimeve siguron, pas tre vite studimi, 180 kredite ETCS. Sipas VKM nr 41, 15-20% të krediteve të programit mësimor duhet ta përbëjnë lëndët bazë (kategoria A e veprimtarive formuese), të përgatisin studentin nga pikpamja metodologjike dhe me kulturë të përgjithëshme, 50-55% të krediteve të duhet të jenë lëndë karakterizuese ose lëndë që e përgatisin studentin për disiplinën shkencore (kategoria B); 12-15% të krediteve të programit të studimit e zënë lëndë ndërdisiplinore/integruese, ku përfshihen nëndisiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje (kategoria C), 10-15% të krediteve duhet të jenë lëndë plotësuese si gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (kategoria D) dhe 3-5% të krediteve programit e zënë detyrimet përmblyëse (kategoria E). Duke krahasuar kriteret e VKM me përfshirjen në planin mësimor të programit mësimor situata paraqitet:</p> <p>Për profilin Manaxhim, Financë- Kontabilitet, Marketing për të tre vitet:</p> <p>Lëndë të kategorisë A zenë 33 kredite ose 19,9%, pra brenda kriterit të VKM 41.</p> <p>Lëndë të kategorisë B zenë 101 kredite ose 54,3%, pra brenda kriterit të VKM nr 41.</p> <p>Lëndë të kategorisë C zenë 23 kredite, ose 12,4%, brenda kriterit.</p> <p>Lëndë të kategorisë D zenë 19 kredite ose 10,2%, brenda kriterit.</p> <p>Lëndë të kategorisë E zenë 6 kredite ose 3,2%, brenda kriterit.</p> <p><u><i>Aneksi Tabelat Permbledhese per Aneks RVB- Tabela 9, Aneks 7, Aneks 14; Aneksi 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.pdf.</i></u></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Sipas shpjegimeve të dhëna në kriterin 6 më sipër, sipas RVB-së rezulton se në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznes, profili Manaxhim, Kontabilitet Financë e Marketing, janë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive nga A-E dhe me ngarkesën përkatëse në kredite, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara nga MASR-ja. Më konkretisht për këtë çështje i jemi referuar për përputhshmëri, VKM nr.41, datë 21.04.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.</p> <p>Sipas planit mësimor të këtij programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi janë të përcaktuara veprimtaritë formuese</p>




	<p>sipas kategorive, të ndara në ETCs, kredite, ore leksioni, ore seminari si dhe ore pune individuale.</p> <p>Ndarja e veprimtarive formuese për programin e studimit është detajuar në kriterin 5 të këtij standarti.</p> <p><i>Aneksi Tabelat Permbledhese per Aneks RVB- Tabela 9, Aneks 7, Aneks 14; Aneksi 14.1_Plani mesimor Bachelor AB 19-20.pdf.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se TBU është një institucion i akredituar -me Urdhërin Nr. 326, datë 15.08.2013 “Për akreditimin institucional dhe të disa programeve të studimit të Shkollës së Lartë Private “TBU”. Fakulteti i Administrim Biznesit në TBU, si njesi kryesore qe ofron kete program studimi është i organizuar në tre departamente: Departamenti i Lëndëve të Pergjitheshme, Departamenti i Kontabilitet Finance, Departamenti i Manaxhimit. Në Statutin e TBU (Aneksi 2) paraqitet struktura e Fakultetit, përbërja dhe funksionimi i tij. Statuti është miratuar me Urdhërin e MASR nr 41, datë 20.09.2017, dhe në përputhje me LAL 80/2015. Sipas ligjit dhe Statutit të TBU, Dekani i Fakultetit si titullar i institucionit, i propozon Rektorit emërimin e Përgjegjësve të Departamenteve (Statuti i TBU, neni 18, neni 24). Përgjegjësi i departamentit është përgjegjës për zbatimin, ecurinë e zhvillimin e programit të studimit. në vecanti, Departamenti i Lëndëve të Pergjithëshme, i cili plotëson kërkesat e Ligjit 80/2015 të Arsimit të Larte, neni 17, pika 7 mbi baze të të cilit është lidhur edhe Marrëveshja që TBU ka lidhur me MASR.</p> <p><i><u>Tabela 2 Aneksi Tabelat Permbledhese per Aneks RVB Urdhëri nr 326 Për Akreditimin</u></i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse	Nga shqyrtimi i dokumentave, për këtë program studimi, me vendim të Dekanit të Fakultetit të Administrim Biznesit është




<p>për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>përcaktuar si koordinator i programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi, Përgjegjësi i njësisë bazë, pra përgjegjësi i Departamentit të Lëndëve të Përgjithshme. Në këtë vendim përcaktohen detyrat e koordinatorit të programit. Dekani i Fakultetit në fillim të vitit akademik përcakton edhe personat përgjegjës për praktikat mësimore të studentëve.</p> <p><u><i>Aneksi nr 36 Vendim per emerimin e koordinatorëve te programeve AB;</i></u> <u><i>Aneksi shtese nr 5, per vitin 2018-2019</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Në zbatim të ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH, neni 17, pika 7, TBU është klasifikuar si Kolegj Universitar, dhe si i tillë, nuk ka detyrim ligjor përmbushjen e pikës 4 të nenit 25 të ligjit. Në përputhje me nenin 17, pika 7 TBU ka nënshkruar “Marrëveshje për përcaktimin e numrit të personelit akademik me kohë të plotë, në njësitë bazë” në datën 5 nëntor 2018.</p> <p><u><i>Aneks shtese nr 6 Marreveshje MASR TBU percaktimi personelit akademik.</i></u> <u><i>Aneks 23 Të dhëna personëli akademik</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se të tre departamentet: Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, Departamenti i Kontabilitet Financë, Departamenti i Manaxhimit, vecanërisht Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme përgjegjës për këtë program studimi, i përmbushin detyrimet ligjore dhe tejkalojnë kërkesën për personel akademik me kohe të plotë referuar marrëveshjes së permendur në kriterin 3 të këtij standarti. Po kështu, personeli akademik i këtij departamenti plotëson kërkesat ligjore për gradën e –titujt shkencorë. Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme– ka në përbërje 13 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 1 Profesor i Asociuar, 2 me gradë Doktor, 1 prej tyre personel akademik në process doktore dhe 9 me diplomën Master i Shkencave (Msc). Po kështu, ky -departament ka në përbërje dhe 3 personel akademik me kontratë, nga të cilët 2 me gradë Doktor dhe 1 personel akademik me diplomë Master i Shkencave (Msc).</p> <p><u><i>Tabelat 1 e 2 Aneksi Tabelat Permbledhese per Aneks RVB,</i></u></p>




	<u>Aneks 23 Të dhëna personeli akademik.</u>			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se TBU dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit plotëson detyrimet ligjore për organizimin e strukturës akademike, sipas sqarimeve të dhëna në kriterin 3 të këtij standarti. <u>Aneks 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</u> <u>Aneksi 20 CV Stafit Akademik Programi Bch AB.pdf</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se Departamenti i Lëndëve të Pergjithshme, si departament përgjegjës për këtë program studimi, propozon dhe ndjek mbarëvajtjen e programit të studimit dhe ndryshimet përkatëse, si në planet mesimore, në programet apo kurrikulat e lëndëve, në përputhje me zhvillimet, me kërkesat e tregut etj. Departamenti ka informacionin e duhur lidhur me organizimin, strukturën e përmbajtjen e këtyre programeve. <u>Aneksi 14 Dosje e programit të studimit me elementet perberes.</u> <u>Aneksi 14.1 Planet mesimore</u>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Sipas RVB dhe dokumentave të TBU, ky program studimi është organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas shpjegimeve të dhëna në Standartin II.1. Në Rregulloren e programit të studimit paraqitet edhe ndarja e lëndëve sipas viteve e semestrave. Miratimi i Planit mesimor dhe i programeve të lëndëve me propozim të departamenteve bëhet nga Senati akademik para fillimit të vitit të ri akademik. Në planin mesimor ndarja e lëndëve/moduleve, bëhet në disa kategori nga A-E: lëndë të formimit të përgjithshëm (A), lëndë të formimit karakterizues (B), lëndë me zgjedhje (C), lëndë të

	<p>formimit plotësues, si praktika (D) dhe tema e diplomës (E). Bazuar në planin mësimor veprimtarite formuese për programin e studimit janë ndare si me poshte:</p> <p>A Lëndeë bazë – 37 ECTS -19.9 % B Lëndët karakterizuese – 101 ECTS - 54.3 % C Lëndët ndërdisiplinore/ Integruese – 23 ECTS - 12.3 % D Lëndët plotësuese – 19 ECTS - 10.2% E Detyrimet përmbyllëse – 6 ECTS - 3.2 %</p> <p>Për ndarjen e lëndëve në kategoritë e mësipërme i jemi referuar edhe suplementit të diplomës.</p> <p><u><i>Aneksi 7 Rregullore e programit te studimit Bsc AB;</i></u> <u><i>Aneks 14.1 Planet mesimore,</i></u> <u><i>Aneksi 15.2 modeli suplementi diplomes.pdf.</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Njesia bazë përgjegjëse për këtë program studimi mban parasysh e zbaton sistemin europian për ndarjen e lëndës në module e tema, për vlerësimin e çdo elementi të procesit mësimor me orë e kredite sipas sistemit vendas dhe atij europian. Format i syllabuseve është i përcaktuar me VKM dhe përgjithësisht zbatohet edhe në këtë program studimi.</p> <p><u><i>Aneks 7 Rregullore e programit te studimit Bsc AB;</i></u> <u><i>Aneksi 14.1 Planet mesimore</i></u> <u><i>Aneks 19 Syllabuset e lëndëve</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se në dosjen e programit të studimit përfshihet edhe Rregullorja e këtij programi, e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë rregullore, e konkretisht në aneksin A janë renditur planet mësimore për 3 vite akademike, pra për 6 semestra, për të tre profilet: Manaxhim, Financë Kontabilitet, Marketing. Sic dihet Plani mësimor është dokumenti kryesor për hartimin e syllabuseve për cdo vit akademik. Në planin mësimor përcaktohet ngarkesa në orë e në kredite e cdo lëndë, e ndarë në ore leksioni, ose seminari, ore individuale pune të studentit jashtë auditorit.</p> <p>Për profilin Menaxhim dhe profiling Marketing: Në vitin e parë studentët fitojnë 60 kredite, në vitin e dytë 62 kredite dhe në vitin e tretë 64 kredite, pra në total 186 kredite ETCS.</p> <p>Ngarkesa në auditor është e ndare ne 915 orë leksionë, 660 orë seminare, pra totali i orëve të mësimimit në auditor është 1555 orë, ndërsa 3075 orë i takojnë punës individuale të studentëve.</p>




Për profilin Kontabilitet dhe Financë: Në vitin e parë studentët fitojnë 60 kredite, në vitin e dytë 62 kredite dhe në vitin e tretë 65 kredite, pra në total 187 kredite ETCS.

Ngarkesa në auditor është e ndare ne 915 orë leksionë, 675 orë seminare, pra totali i orëve të mësimit në auditor është 1590 orë, ndërsa 3085 orë i takojnë punës individuale të studentëve. Në Rregulloren e Programit të studimit dhe procesit mësimesor si dhe në syllabuset e lëndëve jepen të dhëna të detajuara lidhur me detyrimet e frekuentimit të lëndës nga ana e studentëve dhe me mënyrën e vlerësimit të dijeve.

Bazuar në Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU, janë të parashikuara dhe të përcaktuara mënyrat e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit. Kontrolli i dijes për studentët, realizohet nëpërmjet vlerësimit semestral. Skema e vlerësimit për çdo komponent të kontrollit të dijes përcaktohet në syllabus. Kështu në shumicën e lëndëve elementët e skemës së vlerësimit janë:

- Pjesëmarrja në leksione dhe aktivizimi në seminare
- Kontrolli i ndërmjetëm
- Detyra e kursit
- Provimi përfundimtar

Në Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU, neni 16, deklarohet: Për provimin përfundimtar disponohen, si rregull 60 pikë dhe për kontrollet pararendëse së bashku 30 pikë por, në syllabusin e lëndës mund të parashikohet edhe një raport tjetër duke rritur peshën e pikëve për kontrollet pararendëse por jo më shumë së 50 pikë gjithësej.

GVJ referuar syllabuseve konstaton se një pjesë e konsiderueshme e tyre ky nen nuk zbatohet. Psh.

Ekonomia monetare nuk ka të përcaktuar fare vlerësimin e njohurive të fituara gjatë vitit dhe provimin përfundimtar, Sjellja organizative provimi përfundimtar 30% ,

Biznes ndërkombëtar 70% ,

Menaxhim financiar 80%

Statistika e përgjithshme dhe Stastistika e aplikuar 70 %; etj, gjithashtu dhe një pjesë e mirë e syllabuseve nuk janë të formatuara sipas VKM nr. 41 datë datë 24.01.2018, Shtojca nr. 2.



	<p><i>GVJ sugjeron që të rishikohet mënyra e vlerësimit të studentëve në syllabuse dhe të formatohen bazuar në VKM nr. 41 datë datë 24.01.2018, Shtojca nr. 2.</i></p> <p><u><i>Aneks 7 Rregullore e programit te studimit Bsc AB;</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU, nenet 14 e 16;</i></u> <u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Bachelor AB</i></u> <u><i>Aneks 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB, takimit me përfaqësues të zyrës së informimit të studentëve u konstatua se të gjitha informacionet e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit, ekuivalentimit të studimeve trajtohen në Rregulloren e Programit të Studimit dhe Procesit Mësimor. Në fillim të vitit, Fakulteti Ekonomisë, në TBU bën propozimin për kuotat e pranimit të studentëve në programin Bachelor në Administrim Biznes për vitin akademik pasardhës. Parashikimi i numrit të studentëve që do pranohen vitin pasardhës, mbështetet në Studimin e tregut të punës, në analizën e prirjeve të regjistrimeve ndër vite si dhe bazuar në kërkesën e tërheqjes së studentëve nga tregu i punës çdo vit. Programi i paraqitet cdo vit palëve të interesuara, në rradhë të parë studentëve, përmes Guidës së studentit, përmes Javës së orientimit të studentëve.</p> <p><u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU Nenet 2,3,4 dhe 32;</i></u> <u><i>Aneks 7 Rregullore e programit te studimit Bsc AB kreu 3;</i></u> <u><i>Aneksi 28 Te dhena per transferimet e studenteve.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi shtese 20 Shembull vendim ekujivalentimi Bch AB.pdf;</i></u> <u><i>Aneks 47 Të dhëna nga faqja zyrtare web, Link 21.</i></u></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ pas vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit vëren se elementet që formojnë syllabuset e lëndëve, që kanë të bëjnë me strukturën e programit dhe planet mësimore, një pjesë e mirë e tyre nuk janë në përputhje me formatet e miratuara nga VKM nr 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Plani mësimor si një ndër elementet e programit të studimit përmbledh Lëndet/modulet, e për secilën lëndë: Leksione, Seminare, Projekte, Detyra Kursi, Praktika, si dhe gjithë komponentët formues të programit brenda e jashtë auditorit. Lidhur me këtë çështje jemi shprehur edhe në kriteret e tjera të këtij standarti.</p>




	<p><u>Tabela 9 e tabela 14 të Aneksit Tabela përmbledhese për Aneks RVB,</u> <u>Aneks 7 e 19;</u> <u>Aneksi 19 Syllabuset e Lendëve Bachelor AB.pdf</u></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVB konstaton se përmbajtja e programeve të studimit rishikohet, për përmirësim të vazhdueshëm nga njësia bazë apo departamenti përgjegjës.</p> <p>Këto përmirësime kanë të bëjnë me shtim, ndryshim të lëndëve, kombinime të lëndëve që i shërbejnë më mirë formimit të studentëve, etj., brenda planit mësimor, në varësi të kërkesave të tregut të punës. Në zbatim të legjislacionit në fuqi, për ndryshime të planit mësimor nën 20%, propozimi i departamentit për planet mësimore miratohet nga senati akademik, ndërsa për ndryshime mbi 20%, kompetenca i kalon MASR.</p> <p>I gjithë procesi nga propozimi i ndryshimit në planin mësimor deri tek miratimi nga Senati rezulton i dokumentuar pranë departamentit përgjegjës</p> <p><u>Aneks shtese nr 7 Procesi i vendimmarrjes se planeve mesimore viti akademik 2019-2020</u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi është në përputhje me përcaktimet e bëra në LAL 80/2015 dhe aktet nënligjore përkatëse, konkretisht sipas VKM nr 41, datë 24.01.2018. Në rregulloren e këtij programi, theksohet se 1 ETCS apo kredit = 25 orë mësimore pune të studentit, ku nga këto 10 orë janë në auditor dhe 15 orë janë punë individuale ose e pavarur e studentit. Për cdo vit akademik në këtë program studimi, studentit duhet t'i ofrohen lëndë që të grumbullojë jo më pak se 60 kredite (ETCS), që</p>




	<p>barazohen me 1500 orë mësimore në vit, (Aneksi 4.1). Në një javë studenti i këtij programi zhvillon deri në 20 orë mësim në auditor, kohë e cila nuk i kalon përcaktimet e bëra në ligj për këtë qëllim.</p> <p><u>Aneks 7 Rregullore e programit te studimit Bsc AB, neni 13;</u> <u>Aneks 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.</u></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Sipas dokumentave të shqyrtuara në institucion GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në mënyrë të tillë që studentët dy vitet e para zhvillojnë lëndë e marrin njohuri nga lëndë bazë e karakterizuese të programit administrim biznesi, ndërsa në vitin e tretë bëhet ndarja në profile. Karakteristike për këtë program është se zhvillohet cdo vit praktikë profesionale, me lëndë e kredite si cdo lëndë tjetër.</p> <p>Praktikat mesimore shpërndahen gjatë gjithë vitit, paralelisht me zhvillimin e mësimit, ku studentët nxiten e mbështeten përmes rregullimit të orarit të mësimit, të kryejnë praktika mesimore. Këto të fundit janë detyrim e objektiv i realizimit të programit të mësimit, sic është përmendur në Aneks 2 Statuti i TBU, është pas praktikave të realizohet punësimi i studentëve edhe gjatë kohës që vazhdojnë studimet. Nga informacioni i grumbulluar në institucion, TBU lehtëson studentët duke u krijuar mundësi për mësim e punësim me dy fasha orare, paradite dhe mbasdite.</p> <p>Kjo formë organizimi e programit të studimit, ndihmon studentët të punësohen edhe pa mbaruar studimet bachelor, e në master të kenë mundësi të punësohen në një nivel më të lartë në karrierë. Informacion për punësimin e studentëve gjejmë në Link nr 9 në Aneks 47, Aneks 17.</p> <p><u>Aneks 2 Statuti i TBU;</u> <u>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëëë.pdf, Link 9, 17;</u> <u>Aneks 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.</u></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se TBU harmonizon shpërndarjen e lëndëve dhe të praktikës mësimore në semestra per të arritur objektivet formues të rezultateve të të nxënit dhe të aftësimit profesional. Këto rezultate të arritura në këtë program studimi, paraqiten si në faqen e ëeb edhe në Raportet Vjetore të TBU.</p> <p><u>Aneks 2 Statuti i TBU;</u> <u>Aneks 7 e Aneks 14.1;</u> <u>Aneksi 38 Analize e realizimit te objektivave Programi Studimit BachelorAb 18-19.pdf Link nr 9</u></p>




	<p><u>Aneks 47 Link 9 Raportet vjetore TBU;</u> <u>Aneks 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.</u></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Sipas takimeve me stafin akademik, dokumentat lidhur me strukturën e programit të studimit bachelor në Administrim Biznesi, që janë përmendur në kriteret e mësipërme të këtij standarti, rezultojnë se ky program ka marrë për bazë eksperiencat më të mira ndërkombëtare, së fundi edhe eksperiencat e fituara në Universitetin Staffordshire, për t'u përshtatur sa më mirë zhvillimeve të reja, për të lidhur njohuritë teorike me shprehjet praktike. Mundësitë e lëvizjes për praktika si brenda vendit edhe jashtë vendit i ka lejuar studentëve të avancojnë më lehtë studimet në këtë program studimi, por edhe për të vazhduar në nivelet e tjera të studimeve.</p> <p>Në kuadër të projekteve Erasmus +, në bazë të një marrëveshje me Universitetin Staffordshire University në Angli, disa studentë ndoqën një semestër në këtë universitet.</p> <p><u>Aneks 02, Aneks 03 Marrëveshje TBU Universiteti Staffordshire</u></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni, dhe informacioni i marrë në takimin me stafin akademik, GVJ konstaton se ky program i studimit ndahet në veprimtari formuese të vendosura në raporte optimale në orë e kredite, njohuritë teorike e praktike, për të mundësuar aftësimin e studentëve, për arritjen e objektivave formues. Fakti që studentët në vitin e tretë mund të bëjnë zgjedhjen e profilit të tyre, që zhvillojnë lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, në raportet e duhura të orëve, apo fakti që mund të bëhet edhe transferimi i studimeve nga TBU dhe në TBU, u lejon studentëve të arrijnë pritshmëritë e tyre. Në këtë program studimi ofrohen shumë lëndë karakterizuese, për t'u mundësuar studentëve të zgjedhin lëndë të profilit që i përshtatet më shumë.</p> <p>Bazuar në planin mësimor veprimtaritë formuese për programin e studimit janë ndarë si më poshtë:</p> <p>A Lëndët bazë – 37 ECTS -19.9 % B Lëndët karakterizuese – 101 ECTS - 54.3 % C Lëndët ndërdisiplinore/ Integruese – 23 ECTS - 12.3 % D Lëndët plotësuese – 19 ECTS - 10.2% E Detyrimet përmbyllëse – 6 ECTS - 3.2 %</p> <p>Programi i studimit u lejon studentëve të Bachelor të vazhdojnë më tej studimet e tyre në nivelin master në TBU. Kjo mundëson edhe ndjekjen e ecurisë së karrierës së Alumni nga ana e TBU.</p>




	<p><u><i>Aneks 7 Rregullore e programit studimit, neni 5 dhe Aneks 5, neni ;) Link 9, në Aneks 47;</i></u> <u><i>Aneks 17 Studimi per tregun e punes;</i></u> <u><i>14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.</i></u></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti apo njesia bazë në fillim të cdo viti akademik ka detyrim të diskutojë syllabuset e lëndëve të përditësuara, jo vetëm për përshtatjen me nevojat e tregut, por edhe të përditësojë syllabuset me literaturën bazë apo të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Kjo përkon me rishikimin e syllabuseve dhe të leksioneve në drejtim të përfshirjes së rasteve të reja studimore nga praktika e bizneseve vendase apo të huaja. Staf i akademik u prononcua se i ndihmon shumë për këtë përtëritje të syllabuseve me literaturë të përditësuar të viteve të fundit libraria online EBSCO, sipas marrëveshjeve të lidhura dhe tarifave vjetore që paguan TBU.</p> <p><u><i>Aneks 19, Link nr 10, në Aneks 47;</i></u> <u><i>Aneksi 14 Dosja e plote e programit te studimit me elementet perberes te tij.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20</i></u></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Referuar RVB, vizitës në institucion si dhe dokumentave shtesë të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi në TBU, në formë të përmbajtje që nga viti i parë e deri në vitin e tretë harmonizon më së miri dijet e njohuritë teorike me aftësimin praktik të studentëve. Pedagogët e lëndës, në respektim të programit kombinojnë teorinë me shembuj të rasteve praktike nga biznesi shqiptar apo i huaj. Duke qenë se pedagogët vijnë edhe nga praktika, arrijnë ta bëjnë me lehtësi sjelljen e ekspertizës së tyre në auditorë. Studentët mbështeten nga TBU për të kryer praktikën të gjatë të shtrirë gjatë gjithë vitit krahas mësimin me orare fleksibël, apo edhe lejohen të punësohen krahas mësimin. Duke kombinuar njohuritë teorike me ato praktike, të shprehura qartë edhe në planin e programin mësimor, TBU ka ngritur një strukturë të përshtatshme për realizimin e të gjithë objektivëve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p><u><i>Aneks 47 Link nr 9</i></u></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e</p>	<p>RVB dhe vizita në institucion si dhe dokumentat e siguruar, i mundësojnë GVJ të verifikojë se përmbajtja e programeve të studimit mundëson vazhdimin e studimeve apo edhe punësimin</p>




mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	e studentëve për t'u përshtatur kërkesave të tregut si u përmend edhe në kriteret e mesiperme të këtij standarti (kriteret 2,4,5,7).			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	RVB dhe vizita në institucion si dhe dokumentat e siguruar, i mundësojnë GVJ të verifikojë se nisur nga bashkëpunimi i TBU me mbi 120 partnere të biznesit, garantojnë praktikën profesionale, punësimin e studentëve të TBU. Kjo gje mundëson shkëmbime të ndërsjellta, pjesëmarrje në leksione të hapura të specialistëve apo drejtuesve të biznesit, komunikim të njësive baze me bizneset, punësim jo vetëm i studentëve, por dhe i stafit akademik të TBU. Kjo krijon lehtësi për mbikqyrjen në praktikën mesimore të studentëve nga ana e personave të caktuar nga biznesi, por edhe nga ana e pedagogëve të TBU. Ky shkëmbim eksperiencash mundëson marrjen e mendimeve nga ana e biznesit si të përmirësohen kurrikulat e TBU, merren sugjerimet e tyre dhe behen realitet duke i pasqyruar neper syllabuset e lëndëve të programit të studimit për t'u përgjigjur sa më mirë tregut të punës.			
	<i>Aneks 32 Institucionet bashkëpunuese</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	RVB dhe vizita në institucion si dhe dokumentat e siguruar, i mundësojnë GVJ të verifikojë se personeli akademik i këtij program studimi, qoftë ai me kohë të plotë apo të pjesëshme, i plotësojnë kërkesat ligjore në fuqi, përsa i përket plotësimin të kriterëve. Zotërojnë titujt e gradat, kualifikimet e duhura, ekspertizën e duhur në fushën për të cilën janë angazhuar për mësimdhënie. Rezulton se i gjithë stafi akademik i këtij program studimi ka të paktën kualifikimin Master i Shkencave në fushën e përgjithëshme dhe specifike, për të cilën është i

perfshire dhe ka kompetencë dhe përvojë në mësimdhënie. Në këtë program studimi që ofrohet nga **Departamenti i Lëndëve të përgjithëshme** zhvillojnë mësim **13 personel akademik efektiv (PAE)**, nga këta **1 Prof.As, 2 me gradë Doktor, 1 në proces doktore** dhe 9 me diplomë Master i Shkencave (Msc). Ngarkesa e personelit akademik rezulton të mbulohet në masën *Referuar Aneksit Tabelat Përmbledhëse për Aneks RVB, Tabela 6.1* **68% nga personel akademik efektiv dhe 32% nga personel akademik me kontratë.**

Nga këta:

PAE		PAK
Msc	19	11
Dr	4	3
PhD	2	
Prof. AS	4	

Nuk ka personel akademik me më shumë se 180 orë në auditor, vetëm me dy përjshime në lëndë të kompjuterizimit kontabël apo të marketingut. Por, ka staf akademik që mbulon më shumë se tre lëndë, rreth 12 prej tyre. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda IAL është paraqitur sipas VKM 31, datë 29.12.2017 dhe është krahasuar me situatën në Programin e studimit Bsc Administrim Biznesi si më poshtë:

Kategoria Profesor me 140 orë, rezulton me 120-150 orë

Kategoria Lektor 165 orë, rezulton me 120-180 orë

Kategoria Asistent lektor 195 orë rezulton me më pak se 195 orë.

Për krahasimin i jemi referuar Aneksit 25.

GVJ-ja gjykon se pavarësisht faktit që në tërësi respektohet numri i lëndëve për cdo personel akademik dhe nuk tejkalohet ngarkesa e caktuar sipas VKM nr 31 për cdo kategori si: Profesor, Lektor e Asistent lektor, GVJ konstaton se rreth 12 pedagogë mbulojnë më shumë se tre lëndë, dhe **raporti PAE/PAK është 68% /32%**. Në respekt të VKM nr 31 TBU duhet të bëjë një shpërndarje më të studiuar të ngarkesës mësimore për të shmangur këtë problem dhe për të mos çënuar realizimin e objektivave të programit të studimit.




	<p><u>Tabela 6.1 në Aneksi Tabelat permbledhese per Aneks RVB.pdf.</u></p> <p><u>Aneksi 25 Të dhëna tabelore me ngarkesë plotë mësimore të personelit akademik në gjithë programet e studimit</u></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Sipas kriterit 1 të mësipërm personeli akademik që zhvillon mësim në programin Bachelor në Administrim Biznesi, ka kualifikimet e duhura shkencore dhe akademike. Lidhur me cilësinë e personelit akademik të këtij programi, i jemi referuar: <u>Tabela 6,7 e 12 në Aneksi Tabelat permbledhese per Aneks RVB.pdf si dhe Aneks 24; Aneksi 25 Të dhëna tabelore me ngarkesë plotë mësimore të personelit akademik në gjithë programet e studimit.</u></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik që zhvillon mësim në këtë program studimi përpos plotësisht të kriterëve ligjore për kualifikimet akademike në pjesën me të madhe janë edhe eksperte të fushës, manaxhere, drejtore, drejtues biznesesh apo specialistë që punojnë në biznese apo institucione. Kjo ka bërë më të lehtë lidhjen e teorisë me rastet praktike, duke i sjellë ato nga bizneset shqiptare, por jo vetëm.</p> <p>GVJ-ja bazuar në RVB, vlerëson se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, në TBU, plotëson kriteret ligjore për kualifikimet në fushën akademike kërkimore të përgjithëshme dhe specifike.</p> <p><u>Aneksi 20 CV Stafit Akademik Programi Bch AB.;</u> <u>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final</u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e</p>	<p>GVJ vlerëson se cdo njesi bazë përcakton një ose disa pedagoge, personel akademik si drejtues të praktikave mësimore për të ndjekur studentët gjatë periudhës së praktikës mësimore, apo punësisht. Studentët mbikëqyren në praktikë edhe nga një staf në biznesin ku ata zhvillojnë praktikën. Gjithë ky aktivitet dokumentohet për të bërë më pas vlerësimin e studentit në këtë element të programit të studimit, praktikë mësimore. Për rastet kur studenti punon për temë diplome ai udhëhiqet nga një personel akademik i programit të studimit.</p> <p><u>Aneksi shtese 05 Vendim percaktimi drejtuesve praktikës mesimore 2018-2019.pdf;</u></p>




diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p><i><u>Aneksi 34 TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme.pdf;</u></i> <i><u>Aneksi shtese 18 Rregullore e praktikës mesimore.pdf;</u></i> <i><u>Aneksi shtese 05 Vendim percaktimi drejtuesve praktikës mesimore 2018-2019.pdf]</u></i></p>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësues shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Pas vizitës në institucion e RVB, rezulton se ka disa salla me laboratorë në TBU. Për shkak të natyrës së programit të studimit, në laborator zhvillohet lënda e Informatikës, e Mikroekonomisë, e Makroekonomisë. Zakonisht në lëndë për të cilat mësimi zhvillohet në laboratorë për të lehtësuar punën me studentët, punojnë dy personel akademik gjatë orëve të mësimit në laborator. Angazhimi i personelit akademik dhe personelit ndihmës mësues shkencor është i vazhdueshëm në funksion të realizimit dhe mbarëvajtjes së praktikave laboratorike dhe profesionale.</p> <p><i><u>Aneks 22 CV Stafi ndihmes akademik;</u></i> <i><u>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf;</u></i> <i><u>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit.pdf</u></i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			✓	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			✓	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel	Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ

<p>institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>konstaton se në Kreun IV të Rregullores për programet e studimit dhe procesit mësimor jepen të gjithë elementët e mësimdhënies dhe kontrollit të dijes, përfshirë edhe metodat e mësimdhënies dhe në vecanti shpjegohet forma e individualizuar e mësimdhënies.</p> <p>Në nenin 7 të Rregullores – Përshtatja e individualizuar e strukturës së programit mësimor, studentët mund të gjejnë mbështetje për të kërkuar modifikim të strukturës së programit mësimor, duke i dhënë me shume mundësi të zgjedhë lëndë e kredite që i përshtaten më shumë profilit të punës së tij, por gjithmonë në respektim të totalit të krediteve që duhet të fitojë për cdo vit akademik.</p> <p>Në varësi të specifikave të cdo lëndë i gjithë personeli akademik nxitet të përdorë metoda bashkëkohore dhe inovative për realizimin e procesit mësimor, që nga përfshirja e të ftuarve specialë nga fusha të ndryshme, për tematika të vecanta, e deri tek përdorimi i videove me situata e koncepte specifike për të ilustruar ceshtje të caktuara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se TBU ka hartuar Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin e përdorimin e metodave të ndryshme e bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p><i><u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU,</u></i> <i><u>Aneksi 39 Udhëzim për zhvillimin përdorimin metoda inovative mesimdhënies</u></i> <i><u>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB1</u></i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se zhvillimi i procesit mësimor nga stafi akademik kryhet i koordinuar e i monitoruar nga departamentet përkatëse të këtij program studimi.</p> <p>Drejtuesit e departamenteve vëzhgojnë nga afër mënyrën e kryerjes së mësimit, vecanërisht nga kolegë të rinj e jo me shumë përvojë, japin mendime e sugjerime, shkëmbejnë eksperiencë. Performanca e personelit akademik vlerësohet edhe duke marrë shqetesimet apo sugjerimet e studentëve, qoftë përmes bisedave informale, apo përmes përdorimit të intervistave konfidenciale dhe ose përmes pyetësorëve anonimë.</p> <p>TBU është institucion i vogël me jo më shumë se 400 studentë dhe kjo përbën avantazh për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e procesit mësimor. Konkluzionet e marra nga këto vlerësime i shërbejnë procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave, metodave të mësimdhënies si dhe përmirësimit të komunikimit e bashkëpunimit me studentët.</p>




	<p>Në këtë proces të monitorimit të procesit mësimor luan rol të rëndësishëm NJSBC apo Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ngrihet e vepron me vendim të Senatit Akademik dhe raporton përpara tij. NJSBC kryen monitorime periodike gjatë vitit akademik.</p> <p>NJSBC në mënyrë periodike, semestrale e vjetore, dërgon një pyetësor tek të gjithë studentët për të marre opinionin e tyre lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies si dhe vlerësimin e dijeve. Ky pyetësor shpërndahet nëpërmjet një aplikacioni, i cili realizon edhe analizimin e rezultateve të pyetësorëve. NJSBC i përdor këto rezultate të anketimit të studentëve në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor.</p> <p><u><i>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU;</i></u> <u><i>Aneksi 37 Raportet per monitorimin e cilesise;</i></u> <u><i>Aneksi 40 Pyetesori i studentëve</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në kriterin e mësipërm u përmend që janë studentët ata që vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies. Kjo u verifikua edhe gjatë takimit me studentët në institucion. Ata përvec se plotësojnë pyetësorët e përgatitur nga NJSBC, ata kanë përfaqësues në NJSBC dhe në Komisionet e përherëshme të cilësisë. Vlerësimet e studentëve për mësimdhënien në vitin akademik 2019-2020 është pozitiv.</p> <p>Ankesat e studentëve për rezultatet e vlerësimit në provime, mund të shqyrtohen sipas një shkalle hierarkie të caktuar në Statutin e TBU dhe në Rregulloren e TBU.</p> <p><u><i>Aneksi 30 Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilesise;</i></u> <u><i>Aneksi 37 Raportet per monitorimin e cilesise.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU statuti.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH” Nr 80/2015, për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies njihet si strukturë përgjegjëse NJSBC. Rregullat e detajuara të funksionimit të NJSBC përcaktohen në Statutin e TBU-së. Rezultatet e përpunuara të pyetësorëve, NJSBC-ja i dërgon të diskutohen në Dekanat, Rektorat, e më pas ju komunikohen studentëve dhe personelit akademik problemet e evidentuara dhe masat që ka marrë Rektorati dhe Dekanati për të ardhmen.</p>




	<p>Kjo procedurë e ka rritur përgjegjësinë dhe cilësinë e punës së personelit akademik, të mësimdhënies, të infrastruktures, etj. Në takimin me personelin akademik, me NJSBC në TBU, GVJ konstatoi se rezultatet e vlerësimeve periodike të kryera si dhe rezultatet e nxjerra nga ankesat e studentëve bëhen pjesë e diskutimit në mbledhjen e njesisë bazë.</p> <p><u>Aneksi 2 TBU statuti.pdf</u>; <u>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb; Link nr 9.</u></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ u informua se në mbledhjet ku analizohen rezultatet e anketimit, diskutohen praktikat më të mira, por edhe kërkohet të bëhen korrigjimet e nevojshme të problematikave të shfaqura. Në raportet vjetore të TBU publikohen arritjet dhe rezultatet lidhur me cilësinë e mësimdhënies për cdo program studimi. Këto analiza ndihmojnë personelin akademik për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, literaturën dhe mjetet didaktike, strukturën e temave të cdo lënde, si dhe kërkesat për rritje të numrit të personelit akademik.</p> <p><u>Aneksi 37 Raportet per monitorimin e cilesise.pdf</u>; <u>Aneksi 2 TBU statuti.pdf</u>;</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit vëren se në Rregulloren e programeve të studimit dhe Procesit Mesimor janë të percaktuara metodat kryesore të mësimin, të kontrollit të dijeve si: leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, provimet pjesore, provimet përfundimtare, provimet e formimit, projektet e kursit dhe temat e diplomave. Sipas VKM nr 41, datë 24.01.2018, në syllabusin e lëndës/eve jepet informacion i detajuar nëse lënda është e detyrueshme apo me zgjedhje, kreditet, përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit, objektivet e përfitimet nga lënda, forma e kontrollit të dijeve,</p>




<p>çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm ku përfshihen format e vlerësimit të studentëve si përqindje e notës përfundimtare, vlerësimi me pikë në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyar e kursit, përfundimtar, në varësi të llojit të lëndës.</p> <p><u><i>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Nga vizita në TBU dhe takimi me personelin akademik e me studentët, rezulton se në procesin mësimor, personeli akademik i mbështetur nga strukturat e tjera në TBU, kanë eksperimentuar elemente të rinj metodologjike nga viti në vit, mbi bazën e të cilave është bërë i larmishëm lloji i metodave dhe mjeteve të përdorura. Nga shpjegimet e dhëna rezultoi se në lëndën Matematika e Aplikuar, Statistika e Aplikuar, Metodat e Kërkimit, Manaxhimi i projekteve apo Manaxhimi i sistemeve të informacionit, Mikro e Makroekonomi, mësimi ka kaluar nga format e zakonshme tek dhënia për të përgatitur një projekt real nga ana e studentëve, për ta zhvilluar atë hap pas hapi individualisht ose në grupe me 2-4 studentë.</p> <p>Në lëndë të tjera me natyre aplikative është rritur pesha në vlerësimin e detyrave individuale të kursit mbi të dhëna të mbledhura nga vetë studentët. Në lëndë të caktuara me ftesë të pedagogut vijne të japin një apo disa leksione ekspertë të fusheë duke sjellë në auditor të dhëna dhe raste reale që lidhen me kuadrin teorik të lëndës përkatëse. Lidhjes së teorisë me praktikën i shërbejnë edhe leksionet apo seminarët speciale që zhvillohen shpesh në TBU nga personalitete të fushave përkatëse.</p> <p><u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB. ’;</i></u> <u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb.; Link nr 1</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje</p>	<p>GVJ nga takimet me personelin akademik dhe dokumentacionin e depozituar, konstaton se TBU e mbështet personelin e tij akademik për të zhvilluar e përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme kompetencat e tyre didaktike, duke respektuar lirinë e tyre akademike. Është përmirësuar vitet e fundit mësimdhënia, duke i lënë mundësi personelit akademik të përdorë krahas metodave tradicionale edhe ato bashkëkohore si: video të shkurtra shpjeguese të koncepteve ose të rasteve studimore nga praktika. Më pas grupet mësimore ndahen në</p>




<p>me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>grupe më të vogla për të diskutuar rreth pyetjeve të bëra nga pedagogu rreth situatës së treguar përmes videos. Kjo mënyrë nxit të menduarit analitik të studentëve, aktivizimin e tyre në klase, punën në grup. Më pas studentët ftohen të prezantojnë gjetjet e tyre.</p> <p>Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe vizita e 12 pedagogëve nga TBU në Universitetin Staffordshire në kuadër të projekteve Erasmus +.</p> <p><u><i>Aneksi 39 Udhezim per zhvillimin perdorimin metoda inovative mesimdhenies.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare web; Link nr 9</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ bazuar në raportin RVB e dokumenta konstaton se personeli akademik i këtij programi studimi, ka eksperiencën e duhur akademike, në tërësi janë ekspertë në fushën e tyre specifike për të cilën janë angazhuar për të zhvilluar leksione e seminare. Personeli akademik jo vetëm ka eksperiencën e duhur akademike, por kanë edhe një bazë të mirë në ushtrimin e profesionit, në praktikën kombëtare e ndërkombëtare, duke e sjellë ekspertizën e tyre në auditor.</p> <p><u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB;</i></u> <u><i>Aneksi 20 CV Stafit Akademik Programi Bch AB</i></u> <u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ bazuar në raportin RVB e dokumenta e takimin me stafin akademik konstaton se në TBU diskutohet në mënyrë të vazhdueshme në departamente rreth përmirësimit të metodave të mësimdhënies, për ta bërë sa më tërheqëse orën e mësimin e për t'i përfshirë sa më shumë studentët në diskutime. Pas analizës së rezultateve të pyetësorëve nga NjsBC, personeli akademik i anagazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, në reflektim të këtyre analizave përmirëson metodat e mësimdhënies, gjatë zhvillimit të lëndës ose në përfundim të saj, në varësi të ecurisë së studentëve. Në këtë mënyrë studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të mësimdhënies.</p> <p><u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 37 Raportet per monitorimin e cilesise.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 8 Rrregullore e NJSBC.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi,</p>	<p>Zhvillimi i leksionit në mënyrë interaktive, është një metodë mësimdhënie e përdorur nga personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”.</p>




<p>duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Personeli akademik ka përdorur raste nga praktika, ose lektorë të jashtëm kanë sjellë raste të praktikës së bizneseve tona. Në TBU është në qendër studenti, për këtë arsye konceptimi i procesit mësues është bërë në këtë funksion.</p> <p>Edhe eksperiencat nga universitete të huaja, kryesisht mobilitete të personelit akademik me projekte si në rastin e eksperiencave të marra nga Universiteti Staffordshire, kanë nxitur edhe mendimin krijues të personelit akademik e studentëve.</p> <p><u>Aneksi shtese 03 IIA TBU Staffordshire University 2018.pdf</u>; <u>Aneksi 39 Udhezim per zhvillimin perdorimin metoda inovative mesimdhënies.pdf</u>; <u>Aneksi 34 TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme.pdf</u></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Administrim Biznes, nxit mendimin kritik të studentëve, përmes tërheqjes së tyre në diskutim gjatë zhvillimit të mësimit, përmes përdorimit të metodave inovative të mësimit. Kjo arrihet duke i dhënë detyra për tu përgatitur në mënyrë individuale ose në grup studentëve dhe më pas duke i lënë kohë studentit apo grupit të studentëve të diskutojnë gjetjet e tyre në klasë. Nga takimi me studentët përforcojmë mendimin se janë përdorur metoda të reja bashkohore mësimit, që nxisin mendimin e pavarur, krijojnë lirshmëri në komunikimin me studentët. Edhe eksperiencat nga universitete të huaja kanë nxitur të punuarit për metoda të reja të mësimit.</p> <p>GVJ vlerëson se TBU ka vepruar në respektim të kriterëve të këtij standarti.</p> <p><i>[Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb; Link nr 11,12,13]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesit dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësues e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Pas vizitës në institucion me seli në Rrugën e Kavajës, adresa e paraqitur në dokumenta, në ndërtesë të re, ndërtuar me materiale cilësore brenda standarteve të kërkuara. Ambientet ku zhvillohet mësimi janë të ndricura, me sistem individual ngrohje ftohje e me lartësi mbi 3 m, me sistem mbrojtje kundër zjarrit, furnizim me ujë, energji elektrike me dy alternativa në rast nderprerje nga rrjeti, me ambiente shërbimi të nevojshme në cdo kat. Ambiente shplodhëse e rikrijuese në cdo kat për studentët.</p> <p><u><i>Aneksi 42 Mjediset e Fakultetit AB</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Pas vizitës në institucion u verifikua se të gjitha sallat e leksioneve e seminareve janë të pajisura me kompjutera e laptop, projektor, tabela të ndryshme për të shkruar pedagogu apo studentët.</p> <p>Në të gjitha mjediset sigurohet lidhja e internetit EIFI. Kjo bën të mundur zhvillimin e mësimimit on line me video për tema të caktuara. Krijohet mundësi për të zhvilluar mësimin me lektorë të huaj me Skype.</p> <p><u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare web; Link nr 14</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit që është përcjelle nga IAL, DVV, çdo personel akademik me kohë të plotë ka vendin e punës të pajisur si duhet. Ka edhe disa vende pune për personelin akademik me kontratë. Cdo punonjes akademik e administrativ zotëron mjetet e nevojshme teknologjike për kryerjen e detyrës: kompjutera, laptop, printer/skaner. Pajisjet mirëmbahen rregullisht apo zëvendësohen kur është e nevojshme.</p> <p>Në TBU janë instaluar rreth 80 laptope, desktop, të lidhur në rrjet dhe me akses në internet. Është 3 fishuar numri krahasuar me 6 vite më parë. Auditorët janë të pajisur me laptope, projektore sic u përmend më lart.</p> <p><u><i>Aneksi shtese 08 Inventari paisjeve 31.12.2019</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se biblioteka ka më shumë tituj librash se në akreditimin e mëparshëm, është plotësuar pas vizitës se pedagogëve në Univ.Staffordshire, por ende ka nevojë për libra si fond fizik, vecanërisht për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi.</p> <p>GVJ vlerëson faktin që TBU disponon një librari virtuale EBSCO, me rreth 40000 tituj libra, artikuj, punime të ndryshme shkencore me autorë të njohur në fushat prioritare, të</p>




<p>parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>aksesueshme nga cdo student e personel akademik, kudo e kurdo edhe jashtë shkollës, për të cilën paguan një tarifë vjetore.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik u diskutua lidhur me literaturën bazë që përdorin studentët, dhe me mundësinë që kanë studentët të shfrytëzojnë librat që janë gjendje në bibliotekë. Në varësi të lëndës, ka lëndë që pjesën më të madhe të literaturës e kanë në gjuhë të huaj, por ka edhe shumë lëndë me literaturë nga autorë shqiptarë. Nga vizita në bibliotekë vihet re se ka mangësi të literaturës, të librave si fond fizik, për lëndë të ndryshme që zhvillohen në të tre vitet e bachelor të këtij program studimi. U vu re nga përgjigjet e pedagogëve që pjesa më e madhe e materialeve që u jepen studentëve janë në PoëerPoint rreth 80% dhe 20 % u jepet si referencë për t'u kërkuar nga studentët në EBSCO. Problem i studentëve është që nuk duan libra por material ne PoëerPoint. Gjithashtu, si lehtësi për studentët është edhe libri I skanuar që ata e kanë në DropBox. Literatura varet dhe në varësi të lëndës. Ka lëndë që kanë tekst, por prej tyre rezultuan mungesa në bibliotekë, ka dhe lëndë që nuk kanë tekst, për këto mund t'u sugjerohet studentëve të shfrytëzojnë edhe librarine online. Nga marrëveshja që kanë më Erasmus + një grup pedagogësh kanë shkuar në Univ. Staffordshire dhe prej andej kanë sjellë literaturë të kohës.</p> <p><i>Për sa më sipër, GVJ është e mendimit, se institucioni duhet të ndër marrë iniciativa për shtimin e titujve për literaturën bazë dhe ndihmëse, periodikëve, revistave në hard copy.</i></p> <p><u><i>Aneksi 45 Database e teksteve Biblioteka;</i></u> <u><i>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit;</i></u> <u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare web, Link nr 10, Tabela 17;</i></u> <u><i>Aneksi 42 Mjediset e Fakultetit AB</i></u></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas informacionit gjatë vizitës e sipas dokumentave, cdo vit TBU abonohet në librarinë on line EBSCO, qysh nga viti akademik 2014-2015. Libraria elektronike shfrytëzohet nga personeli akademik dhe studentët për artikuj shkencore, pjesmarrje në konferenca shkencore, libra apo raste studimore.</p> <p><u><i>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit;</i></u> <u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare web, Link nr 10.</i></u></p>




<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Sipas informacionit gjatë vizitës e sipas dokumentave, laboratori që përdoret për mësim është ai i IT, për specifikat e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi. Ndërsa, për lëndë të tjera specifike përdoret salla e kompjuterave në mjediset e bibliotekës, sipas temës specifike që mund të ketë nevojë për përdorimin e kompjuterave. Ky mjedis është i hapur për studentët edhe ditën e shtunë ora 09-21.00.</p> <p><u><i>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit;</i></u> <u><i>Aneksi shtese 16 Plani per Biblioteken.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ bazuar në raportin RVB e dokumenta konstaton se TBU po bën testimin e një sistemi interaktiv online (Sistemi i Manaxhimit të Studentëve) që i shërben studentëve për të marrë informacion për notat, për të komunikuar me stafin, për të lexuar materiale mësimore, për ecurinë e pagesave, për eventet e TBU. Sistemi i shërben edhe personelit akademik për të hedhur nota, për të komunikuar e hedhur materiale për studentët, për të komunikuar me strukturat e TBU.</p> <p><u><i>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit</i></u> <u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Tab.17.</i></u> <u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf;</i></u></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Sipas informacionit marrë në TBU personeli akademik e administrativ janë pajisur me adresë email të identifikuar me TBU (emer.mbiemer@tbu.edu.al) si dhe të gjithë studentët janë pajisur me adrese email (emer.mbiemer@tbu.al). Krahas sistemit intranet dhe ëeb-site, sekretaria mësimore, sipas vizitës së bërë në atë zyrë, njofton rregullisht studentët dhe personelin akademik mbi procesin mësimor, shpërndarjen e materialeve didaktike, aktivitetet e ndryshme e deri tek informacionet e personalizuara. Informacionet për lëndën, pedagogun përkatës për çdo lëndë, kalendarin e orarin e mësimit, e komunikon sekretaria mësimore. GVJ sugjeron se TBU duhet te ngreje nje sistem te brendshem per te aksesuar dokumentacionin, si nga stafi dhe nga studentet.</p> <p><u><i>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit</i></u></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në</p>	<p>Nga informacionet e marra në mënyrë të kryqëzuar nga studentët, stafi akademik, dokumentat, konstatuam se kur studentët zgjedhin të bëjnë mbrojtje temë diplome, duhet të bëjnë kërkesë në department. Bazuar në nenin 27 të Rregullores së Programeve</p>




rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	të Studimit dhe Procesit Mësimor ata ndiqen nga stafi akademik gjatë e deri në fund të procesit të mbrojtjes. <i>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab</i> <i>Aneksi shtese 01 Udhezim për përgatitjen e temes se diplomes</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ bazuar në raportin RVB e dokumenta konstaton se TBU ka ngritur strukturën e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, Njesinë e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë NJSBC në nivel institucional, e cila bashkërendon punën me departamentet. Në perputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, TBU ka krijuar në nivel institucional dhe në nivel të njesive kryesore Komisionet e cilësisë, të cilët kanë për detyrë garantimin e standarteve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit, marrë në konsiderate dhe Rregulloren e Organizimit të Organeve Kolegjiale të TBU. Edhe koordinatorët e programeve të studimit, në bashkëpunim me NJSBC mbikqyrin procesin mësimor. Kontrolli dhe mbikqyrja bëhen edhe nga njesia kryesore në bashkëpunim me NJSBC-në. Këto njesi bëjnë përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie e mësimnxënie. Të gjitha strukturat e TBU mbështesin përmirësimet e vazhdueshme të mësimdhënies, përfshi metodat e reja innovative të tyre. <i>Aneksi shtese 09 Rregullore për funksionimin e organeve kolegjiale;</i> <i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf;</i> <i>Aneksi 36 Vendim per emerimin e koordinatorëve te programeve AB.pdf</i>




<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Lëndëve të Përgjithëshme është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi. Këto përgjegjësi janë përcaktuar në Statutin e TBU dhe në Rregulloren e Njesisë Bazë. Në TBU njësia bazë është njësia përgjegjëse për të gjitha aspektet akademike, kurrikulare, përfshi personelin akademik që zhvillon mësim në këtë program dhe për cilësinë e tij. Njësia bazë është qeliza ku fillon cdo diskutim dhe formohen propozime për cdo element që ka lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programit të studimit. Njësia bazë dhe strukturat e tjera të TBU nxisin studentët të jenë pjesë e procesit të evidentimit dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p><u><i>Aneksi 2 TBU statuti;</i></u> <u><i>Aneksi 6 Rregullore njesisë bazë TBU</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Njësia bazë apo departamenti ka rolin kryesor në promovimin dhe mbështetjen e metodave të reja inovative të mësimdhënies, por departamenti mbështetet në vazhdimësi nga të gjitha strukturat në nivel fakulteti e nga organet e tjera drejtuese. Kjo reflektohet në formën e mësimdhënies të shumë lëndëve të këtij program si dhe në metodat e vlerësimit të studentit ku përmenden: projektet, punët në grup, analiza e diskutimi i rasteve studimore. Në lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, metodat inovative fokusohen kryesisht në kryerjen e leksioneve nga specialistët më të mirë të fushës nga brenda apo jashtë fakultetit, nxitjen e punës në grup të studentëve, në analizën e rasteve studimore etj. Nga ana tjetër personeli akademik mund të zhvillojë mësimin me anë të mjeteve vizuale, laboratorëve, për të ndihmuar mësimdhënien e lëndëve specifike që kërkojnë përdorimin e teknologjisë.</p> <p><u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB;</i></u> <u><i>Aneksi 39 Udhezim për zhvillimin përdorimin metoda inovative mesimdhënies.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Veprimtaritë në të cilat anagazhohen personeli akademik në TBU, sipas dokumentave janë: mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe zhvillimi profesional individual, si dhe mbështetje nga TBU. Respektohen edhe kriteret ligjore të titujve e gradës (Doktor) të personelit akademik (me kohë të plotë e të pjesëshme). Disa anëtarë të stafit akademik që zhvillojnë mësim në këtë program studimi, kanë kryer studime universitare dhe ose pasuniversitare jashtë vendit në universitete europiane apo</p>




	<p>amerikane. Në vecanti personeli akademik i TBU dhe i këtij program studimi në vecanti, si ata me kohë të pjeseshme edhe ata me kohë të plotë dallohen për eksperiencën e gjatë praktike, dhe lidhjet e perditeshme që kanë me bizneset dhe zyrat e kontabilitetit, institucionet dhe rrethet profesionale si dhe që kanë kryer kualifikime dhe trainime pasuniversitare apo jane pajisur me certifikata profesionale. Sipas Strategjisë Kërkimit Shkencor të TBU, meqenëse TBU është Kolegj Universitar, me numër të kufizuar studentësh, numër të kufizuar personeli akademik edhe pretendimi për kërkimin shkencor nuk është shumë i madh. Megjithatë, TBU kërkon gjithë personelin akademik të angazhohet në kërkimin shkencor si atë efektiv edhe atë me kontratë. TBU përdor edhe stimuj financiarë për këtë qëllim. Nga aneksi 43 gjejmë të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik të Departamentit Lëndëve të Përgjithëshme, përgjegjës për programin e studimit.</p> <p><u><i>Aneksi 3.2 TBU strategjia e kerkimit shkencor 2018.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 43 Te dhena kerkimi shkencor stafi akademik.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 20 CV Stafi Akademik Programi Bch AB;</i></u> <u><i>Aneksi 39 Udhezim per zhvillimin perdorimin metoda innovative mesimdhenies.pdf;</i></u> <u><i>Tab 19, Aneks Tabelat perbeledhese per Aneks RVB</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Sipas RVB, personeli akademik i këtij program studimi, i brendshëm apo me kohë të pjesëshme është i përditësuar me metodat e reja innovative të mësimdhënies, të cilat i pasqyrojnë në përmirësimin e kurrikulave, por edhe të metodave të mësimdhënies. Gjatë këtij procesi përmirësimi ata mbështeten nga njësitet bazë dhe hallkat e tjera të strukturës organizative të njesisë kryesore apo në nivel institucioni. Në shërbim të këtij procesi përditësimi kanë qenë dhe aplikimet për projektet Erasmus + që kanë patur si qëllim shkëmbimin e stafit dhe të studentëve. TBU ka përvujtë e implementimit të këtij projekti gjatë periudhës Janar-Maj 2018 dhe Shtator Tetor 2019 me Univ.Staffordshire në Mbretërinë e Bashkuar. Eksperiencat e marra atje u transmetuan edhe me pedagogët e tjerë të TBU. Gjatë periudhës 2020-2021, do vazhdojë zbatimi i të njejtit projekt, ku personel akademik e studentë të TBU do shkojnë për shkëmbim experience si dhe për mundësi të kërkimit shkencor në Un. Staffordshire. Pritet të zbatohet edhe projekti me Univ.FH Bielefeld ku pritët që personeli akademik i TBU do të vizitojë këtë universitet.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli</p>	




<p>ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik i programit studimit Bachelor në Administrim Biznesi, i mbështetur nga personeli ndihmës akademik dhe strukturat e tjera të TBU raportojnë periodikisht për rezultatet mësimdhënies, metodave të reja të sjella edhe nga eksperiencia jashtë, rasteve të reja studimore të sjella nga praktika e biznesit në department, duke marrë mendime e duke shkëmbyer eksperiencia e duke i promovuar metodat e reja. I gjithë ky proces regjistrohet e publikohet në faqen e ëeb të TBU për të informuar personelin akademik e studentët.</p> <p><u>Aneksi 43 Te dhena kerkimi shkencor stafi akademik.pdf</u>; <u>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Link 11,12,13</u>; <u>Aneksi shtese 04 TBU Inter-Institutional Agreement Bielefeld</u>; <u>Aneksi shtese 03 IIA TBU Staffordshire University 2018.pdf</u>; <u>Aneksi 50 Te dhena nga plani i financimit te programit te studimit bch.AB.pdf</u>; <u>Aneksi 39 Udhezim per zhvillimin perdorimin metoda inovative mesimdhënies.pdf</u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton pas shqyrtimit të dokumentacionit e vizitës në institucion se kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale vendosen në: Rregulloren e përgjithëshme të TBU, Rregulloren e Provimeve, Rregulloren për programet e studimit. Rregullorja për programet e studimit dhe procesit mësimor, në nenin 16 përcaktojnë sistemin e vlerësimit me notë të studentit, dhe shërben si orientim për strukturën e këtij vlerësimi. Studentët njihen me rregulloren qysh në fillim të vitit akademik, duke mësuar të drejtat dhe detyrimet e tyre, edhe si pjesë të kontrates se shkollës me studentin.</p>




	<u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Link 15-Dokumenta ligjore, si Rregullore e Programit të Studimit dhe e procesit mësimor</i></u>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Në fillim të vitit akademik studentët në cdo lëndë marrin nga pedagogu në ditën e parë të leksionit programin e lëndës ku përfshihen përvec temave, përfitimeve nga lenda edhe detyrimet e lëndës si: sistemi i vlerësimit të lëndës, vlerësimi për aktivizimin në mësim, detyrat e kursit, testi i ndermjetem, testi përfundimtar etj. Ky informacion për vlerësimin e lëndës saktësohet edhe në Rregulloren e TBU, Rregulloren e Programit të Studimit dhe të Procesit Mësimor. Ky informacion ju dërgohet studentëve edhe me email që në javën e parë të fillimit të lëndës.</p> <p><u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Link 15-Dokumenta ligjore, si Rregullore e Programit të Studimit dhe e procesit mësimor:</i></u></p> <p><u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB</i></u></p>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>GVJ konstaton pas shqyrtimit të dokumentacionit e vizitës në institucion se për të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, struktura e vlerësimit të tyre është e përbërë nga disa elemente si: pjesëmarrja aktive në mësim, provime të pjesëshme, prezantime, projekte individuale apo në grup, provime përfundimtare etj. Struktura mund të ndryshojë nga lenda në lëndë, në varësi të specifikave të saj në cdo rast, struktura e lëndës mundëson vlerësimin e studentëve bazuar në disa elemente në përputhje me Rregulloren për programet e studimit dhe procesit mësimor, duke i dhënë mundësi studentit të tregojë njohuritë e marra dhe kompetencat e fituara. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, pohime/mohime, pyetje shpjeguese, kuptim e zëbërthim konceptesh, ushtrime e raste.</p> <p><u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB.pdf;</i></u></p> <p><u><i>Tabela 15 në Aneks Tabelat përmbledhese për Aneks RVB</i></u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓ X




Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>GVJ konstaton nisur nga RVB se kontrolli i dijeve për cdo lëndë është i vazhdueshëm, duke e mbajtur studentin të angazhuar gjatë gjithë procesit të zhvillimit të lëndës. Vlerësimi final i tij është tërësia e vlerësimeve të vazhdueshme të bëra gjatë vitit përmes testeve apo projekteve finale sipas specifikave të lëndës.</p> <p>Në totalin prej 100 pikë, pjesëmarrja në mësim, si rregull, vlerësohet me maksimumi 10 pikë. Ky vlerësim mund të jetë me më shumë se 10 pikë nëse përcaktohet shprehimisht në syllabusin e lëndës. Pjesa tjetër prej 90 pikë shërben për provimin përfundimtar dhe tërësor të lëndës si dhe për kontrollet pararendëse të dijës në atë lëndë (detyra kursi, provime pjesore etj). Për provimin përfundimtar disponohen, si rregull 60 pikë dhe për kontrollet pararendëse së bashku 30 pikë por, në syllabusin e lëndës mund të parashikohet edhe një raport tjetër duke rritur peshën e pikëve për kontrollet pararendëse por jo më shumë se 50 pikë gjithësej.</p> <p>Të gjitha detyrimet përfshihen në programin apo syllabusin e lëndës.</p> <p>Ky sistem i vlerësimit të njohurive të studentëve, i nxit e i motivon studentët të mësojnë në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit, në auditor dhe në mënyrë të pavarur.</p> <p><u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB;</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU.pdf</i></u> <u><i>Tabela 15 në Aneks Tabelat permbledhese per Aneks RVB.</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në Rregulloren e Përgjithëshme të TBU dhe rregulloret e tjera në plotësim të saj parashikohen kriteret, kërkesat dhe procedurat që shërbejnë për testimin e aftësive të studentëve. Duke iu referuar kriterit 1, në ato lëndë në të cilat është e mundur, realizohet testimi i studentëve në mënyrë elektronike si në: Informatikë apo Softëare aplikative. Në pjesën më të madhe të lëndëve që zhvillohen në këtë program ato zhvillohen nga të paktën dy pedagogë dhe si rrjedhim edhe komisionet që testojnë njohuritë e studentëve janë me të paktën dy pedagogë, ku njeri është titullar i lëndës.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre</p>	<p>Kushti që testimi i dijeve të bëhet nga grup pedagogësh, e jo vetëm nga një pedagog, është i vendosur edhe në Rregulloren për</p>




<p>është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>programet e studimit dhe procesit mesimor, për të bërë vlerësimin sa më të drejtë e të saktë të studentit. Vlerësimi bëhet nga të paktën dy pedagogë edhe sepse mësimi zhvillohet nga të paktën dy pedagogë: lektori dhe pedagogu që zhvillon seminarët, për këtë arsye në provimet e pjeseshme dhe në provimin perfundimtar marrin pjesë e vlerësojnë studentin të paktën dy pedagogë.</p> <p><u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</i></u> <u><i>Tabela 12 në Aneks Tabelat permbledhese per Aneks RVB;</i></u> <u><i>Aneksi shtese 12 Nje model kazusi provim formimi Bch AB.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në TBU në bazë të Rregullave për mbarevajtjen e procesit mesimor, testimi i studentëve kur ky bëhet me shkrim, bëhet i sekretuar, duke përdorur ID e cdo studenti, nga ana e Sekretarisë mesimore. Vlerësimi i njohurive në fund të vitit bëhet duke ruajtur sekretin dhe korigjimi bëhet duke ruajtur sekretin dhe korigjimi bëhet në mënyrë anonime. Format e kontrollit parashikohen në rregulloren e provimeve në mënyrë të detajuar dhe zbatohen me kujdes. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Komisioni i provimit propozohet nga përgjegjësi i Njesisë Bazë dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit një ditë përpara zhvillimit të testimit/provimit. Tezat sekretohen nga sekretaria me barkod dhe kontrollohen nga pedagogu pa emra. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatin në fletën e provimit. Provimi nuk zhvillohet asnjëherë pa sekretim, dhe realizohet në disa salla, të cilat kanë edhe kamera për monitorim të procesit të provimit.</p> <p><u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</i></u> <u><i>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mesimore;</i></u> <u><i>Aneksi shtese 10 Rregullore për mbarëvajtjen e procesit mesimor Neni 20</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të</p>	<p>GVJ konstaton se në TBU cdo student bazuar në Rregullat për mbarëvajtjen e procesit mesimor, pavarësisht nga forma e testimit, provim apo projekt, si në fletën e provimit edhe tek projekti final, kanë të shprehur një “feed back” në lidhje me rezultatin, pra kanë të drejtën e ankimit e rishikimit të procesit të vlerësimit.</p> <p>Nga kontrollet që bëhen gjatë vitit, studentëve u jepen detyra për të punuar individualisht apo në grup, të cilat i paraqesin në klasë apo i dorëzojnë dhe pedagogu i vlerëson. Diskutimet në klasë,</p>




<p>përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>këshillat nga ana e pedagogut, përmirësojnë njohuritë që janë konstatuar të mangëta në provime.</p> <p><u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</u> <u>Aneksi shtese 10 Rregullore për mbarëvajtjen e procesit mësimor Neni 22</u></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se në TBU procesi i provimit monitorohet nga komisioni i provimit, duke mos lejuar kopjimin e provimeve. Gjithashtu, personeli akademik i cdo lëndë kujdeset të eliminojë këtë problem edhe në detyrat apo projektet e kursit. Për këtë qëllim përdoret shpesh kombinimi i provimit me shkrim edhe me gojë.</p> <p>Njësitë bazë dhe personeli akademik respektojnë Rregulloren e Institucionit TBU dhe të procesit mësimor, ku parashikohen nenet lidhur me procesin e zhvillimit të provimeve. Parashikohet edhe mënyra e mbikqyrjes dhe të masave ndëshkuese në rast kopjimi gjatë procesit të provimit, në rast plagjiature, pra të kopjimit të projekteve të kursit etj.</p> <p><u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU, neni 20;</u> <u>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore</u></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Institucionit, në takimin në institucion, mësohet se korrigjimi i provimeve kryhet nga pedagogu/et e lëndës, Brenda nje afati si rregull, jo më shumë se 1 jaë nga dita e provimit dhe rezultatet dorëzohen në sekretarinë mësimore. Sekretaria mësimore njofton në mënyrë konfidenciale me email studentët për rezultatet e provimeve brenda një afati 3 ditor nga dorëzimi i rezultateve të tyre nga ana e pedagogëve të lëndës. Nëse rasti lidhet me çështje të etikës, ai do të trajtohet sipas kodit të etikës, por pa efekte në notën e dhënë nga pedagogu. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit, teza origjinale depozitohet në department.</p> <p><u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU , neni 22;</u> <u>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore</u></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së institucionit, Rregullores për programin e studimit dhe procesit mësimor, studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit të provimit brenda një afati 3 ditor nga dhënia e njoftimit dhe ankimimi i njoftohet menjëherë pedagogut të lëndës.</p> <p><u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU, neni 22;</u></p>




	<u>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab.pdf</u>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas Rregullores së Institucionit dhe procesit mesimor, shqyrtimi i ankimimit kryhet nga pedagogu i lëndës brenda 7 ditësh nga marrja e njoftimit nga sekretaria. Vendimi i tij për notën është përfundimtar. Nëse rasti lidhet me çështje të etikës, rasti do trajtohet me kujdes sipas kodit etikës, po pa efekte në notën e dhënë nga pedagogu. Mbas kësaj faze nëse studenti nuk bindet për sqarimin e dhënë lidhur me rishikimin e rezultatit, atëhere ka të drejtën e ankimimit në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet nga një komision i vecantë.			
	<u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU , neni 22</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ konstaton nisur nga RVB se programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes është i organizuar në mënyrë të tillë që studentët në të dy vitet e para të studimeve marrin njohuri dhe aftësi të përgjithëshme që i përkasin fushës së Administrim Biznesit, ndërsa në vitin e tretë të studimeve lëndët e ofruara janë me të thelluara në njohuritë që u ofrojnë studentëve duke mundësuar zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Praktika profesionale sipas planeve mesimore të TBU është pjesë përbërëse e kurrikulës së këtij programi studimi në cdo vit studimi, praktika mësimore në vitin e tretë është më e specializuar dhe ka më shumë kredite ETCS. Gjatë viteve të parë e të dytë, studentët nxiten të provojnë disa pozicione pune gjatë praktikave profesionale, apo dhe të punësimit, në mënyrë që praktikat e tyre në vitin e tretë t’i përshtaten specifikeve dhe aftësive të cdo studenti dhe që kanë lidhje më të ngushtë me fushën dhe me profilin e tyre të studimit.
	<u>Aneksi 7 Rregullore program studimi Bsc Administrim Biznesi ;</u>




	<p><u><i>Aneksi 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf]</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ konstaton nisur nga RVB se qysh në vitin e parë të studimeve, pjesë e programit janë dy lëndë që zhvillojnë aftësitë e studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit: Informatika e Përgjithëshme dhe Softëare Aplikative, dy lëndë të gjuhës angleze: Anglishte e Përgjithëshme dhe Anglishte e Biznesit, si dhe lënda Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal, të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të vecanta të studentit në këto fusha dhe mbështesin përgatitjen e tij profesionale.</p> <p><u><i>Aneksi 7 Rregullore program studimi Bsc Administrim Biznesi;</i></u> <u><i>Aneksi 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf]</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentit pas përfundimit të cdo lënde, evidentohen në fund të lëndës, kur studentit dorëzon detyrën e kursit apo projektin, apo nëse e mbron lëndën me provim me shkrim, ku studentit duhet t'i përgjigjet pyetjeve jo vetëm teorike, por edhe rasteve studimore. Në këtë mënyrë vlerësohen aftësitë e kompetencat e fitura nga studentit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Sipas RVB në përfundim të çdo lënde nga personeli akademik zhvillohet një leksion përmblyës, ku përmbledhen të gjitha temat, duke shpjeguar çështjet kryesore. Po kështu, në fund të lëndës studentët duhet të dorëzojnë një projekt final. Edhe në rastin e provimit përfundimtar me shkrim, pyetjet janë të tilla që e vënë studentin në situatë zgjidhje problemesh se sa thjesht pyetje rreth njohurive të fituara.</p> <p>Nga informacioni i marrë në takimet me personelin akademik e studentët të TBU, por edhe nga RVB, GVJ mësoi se në përfundim të cdo lënde, zakonisht orët e fundit të zhvillimit të lëndës, pedagogu përkatës analizon në klasë çështjet më të rëndësishme të lëndës, duke i orientuar për zbatimin në praktikë të atyre njohurive.</p> <p>Ky element përcaktohet qartë dhe në syllabuset e lëndëve, në formën e përsëritjes në fund të lëndës apo në cdo formë tjetër që ka si qëllim pikërisht analizimin e njohurive dhe kompetencave të fituara nga studentët.</p>




	<p><u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB.;</i></u> <u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 38 Analize e realizimit te objektivave Programi Studimit BachelorAb 18-19.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga RVB dhe takimi me personelin akademik GVJ mësoi se përvec lektorëve të ftuar në lidhje me zhvillimet më të fundit që kanë lidhje me tematika specifike, të realizuara nga pedagogët e disa lëndëve, TBU si institucion realizon përgjatë gjithë vitit seminare të hapura për tema e zhvillime të reja që kanë lidhje me fushën e administrim biznesit, në të cilat kërkohet pjesmarrja e studentëve. Studentët i evidentojnë këto pjesmarrje në raportet e tyre të praktikës profesionale që kanë detyrim të dorëzojnë për praktikat profesionale të cdo viti akademik.</p> <p><u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb. Link nr 1:</i></u> <u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik GVJ mësoi se harmonizimi i formimit teorik me aftësimin e njëkohshëm praktik, me zbatimin në laborator të njohurive të marra në lëndë specifike i vlerësuar me notë e kredite, mundësojnë punësimin edhe para mbarimit të ciklit bachelor, kjo është risi që sjell TBU. Aftësimi praktik përfshin edhe aftësimin për kërkim shkencor kryesisht aplikativ. Gjithashtu, në disa prej lëndëve që zhvillohen në vitin e tretë të studimeve, studentët marrin njohuri e aftësohen edhe për të qenë sipërmarrës. Personeli akademik nxit çfarëdo ide biznesi të studentëve duke i mbështetur ata në idetë e tyre për hartimin e planit të biznesit. Është praktikë e mësimdhënies në TBU diskutimi në grup në orët e mësimi. Kjo rezulton një mënyë efikase për t'i aktivizuar studentët gjatë zhvillimit të mësimi në auditor. Ky element i rëndësishëm i procesit mësimor pasqyrohet edhe në syllabus.</p> <p><u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB shembull Syllabus I Lëndës Manaxhim i Biznesit të Vogel.</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU , neni 22</i></u></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të</p>	<p>Sipas RVB vërehet se në Strategjinë e TBU-së, përcaktohet se procesi mësimor zhvillohet me në qendër studentin. Nga dokumentacioni që është përcjellë nga IAL, DVV, dhe takimet me personelin akademik rezulton se personeli akademik</p>




<p>avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>komunikon në mënyren e duhur me studentët, duke u perpjekur të tërheqë vëmendjen e studentëve gjatë leksionit, përmes videove, rasteve studimore nga praktika, drejtimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve, vlerësimin e tyre. Aktivizimi i studentëve mund të arrihet edhe përmes dhënies paraprakisht të leksionit studentëve për ta studiuar e më pas diskutohet në auditor, përmes përgjigjes së pyetjeve e përqëndrimit në çështjet më të rëndësishme.</p> <p>Sipas Rregullores së Institucionit, studentët kanë mundësi të zgjedhin diplomë, përvec provimit të formimit. Diploma paraprihet me përgatitje të eseve, projekteve, detyrave të kursit dhe elementeve të tjere të formimit teorik e praktik. Në të gjitha rastet studentët prezantojnë punimet e tyre para klasës dhe aftësohen të referojnë me saktësi dhe qartësi. Staf i akademik nxit çfarëdo ide biznesi të studentëve duke i mbështetur ata në idetë e tyre për hartimin e planit të biznesit apo për t'í paraqitur në formën e punimeve në konferenca shkencore.</p> <p><u><i>Aneksi 3.1 TBU strategjia e zhvillimit 2018.pdf</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU , neni 22]</i></u> <u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB Link nr 11,12,13,te Aneks 47.</i></u></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Sipas RVB e vizitës në institucion konstatohet se TBU, mbështet nisma sipërmarrëse të studentëve. Studentët kanë të drejten për aplikim pranë institucioneve kombëtare e ndërkombëtare si dhe pranë Universitetit edhe për financime të veprimtarive kërkimore shkencore të tyre. Në vitin akademik 2016-2017 është krijuar Inkubatori i Biznesit në TBU, i cili ndihmon studentët të arrijnë progres dhe të materializojnë idetë e tyre sipërmarrëse. Takuam disa studentë që kishin celur bizneset e tyre dhe kishin punësuar studentë të TBU. Aktualisht 2 prej tyre kanë përfituar grantë të financuara nga PNUD për idetë e tyre të biznesit; ndërsa TBU përmes inkubatorit ka vënë në dispozicion të këtyre studentëve mjedise të shkollës, pajisje, lidhje me internet, këshillim nga stafi akademik ose persona me eksperiencë, bashkëpunim me bizneset partnere për të siguruar mbështetje financiare e teknike.</p> <p><u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf:</i></u> <u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb Link nr 9.</i></u></p>




<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Personeli akademik i TBU siguron që metodat e mësimdhënies të jenë bashkëkohore për të rritur mobilitetin e studentëve të këtij programi. Gjatë vitit 2019-2020, studentët që kishin përfunduar vitin e tretë të këtij programi u bënë pjesë e projektit Erasmus +, të përmendur më lart, për të kryer një semestër në Univ.Staffordshire. Ky qëllim arrihet duke rritur cilësinë e personelit akademik, por edhe duke bashkëpunuar me fakultete, biznese, institucione, për të shkëmbyer ekspertizë. Edhe bashkëpunimet me universitete jashtë vendit, edhe përpjekjet për të shkruar projekte e për të fituar projekte i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, shtimit të mobiliteteve të personelit akademik e të studentëve për të marrë eksperiencë që do i ndajnë në auditorë.</p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur nga TBU për pjesëmarrjen në projekte të huaja, rezultoi se TBU ka fituar e vënë në zbatim 3 projekte.</p> <p><u><i>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf;</i></u> <u><i>Aneksi 43 Te dhena kerkimi shkencor stafi akademik.pdf</i></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimet me studentët e stafin akademik GVJ mësoi se procedura dhe kriteret për diplomimin e studentëve janë saktësuar në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor. Njësitë bazë para se të nisë semestri i dytë i vitit të fundit, njoftojnë studentët me email për t'í informuar për formën e diplomimit dhe afatet përkatëse.</p> <p><u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU</i></u> <u><i>Aneksi shtese 01 Udhezim për përgatitjen e temes se diplome</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në</p>	<p>Njësitë bazë apo departamentet përgjegjëse për këtë program studimi, udhëzojnë studentët për procesin e diplomimit. Përgjegjësi i njësisë bazë të programit të studimit në fillim të semestrit të gjashtë të mësimin, miraton temat e diplomës dhe</p>




<p>dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>udhëheqësit për cdo student të nivelit bachelor. Në funksion të mbështetjes që u jepet studentëve, të cilët zgjedhin të diplomohen me teme diplome janë gjithë strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik sipas Rregullores së Institucionit TBU, neni 27-30 edhe Udhëzimit për Përgatitjen e Temës Diplomës.</p> <p><u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</i></u> <u><i>Aneksi shtese 01 Udhëzim për përgatitjen e temes se diplomes</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Mbrojtja e diplomës, sipas Rregullores së institucionit neni 27, mund të realizohet me temë diplome apo me provim formimi. Me propozim të përgjegjësit të njesisë bazë e me urdhër të Dekanit ngrihet Komisioni i mbrojtjes së diplomës me provim formimi. Komisioni realizon testimin duke përdorur raste studimore, specifike për cdo profil, për të testuar njohuritë e marra nga studenti në të gjithë modulet, ku peshën me të madhe e zenë lëndët e profilit përkatës. Sipas nenin 27 të Rregullores së institucionit, studentët që fitojnë të drejtën të përgatisin temë diplome, duhet të kenë notë mesatare mbi 7.</p> <p><u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</i></u> <u><i>Aneksi shtese 11 Miratimi dekani komisione diplomimi Bch AB 2019</i></u> <u><i>Aneksi shtese 12 Nje model kazusi provim formimi Bch AB;</i></u> <u><i>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së institucionit, përgjegjësit e njesive bazë përkatëse, në fillim të semestrit të gjashtë të mesimit, miratojnë temat e diplomave për cdo student Bachelor dhe pedagogun udhëheqës përkatës. Nga ky moment cdo student, të cilit i është caktuar udhëheqësi fillon punën për përgatitjen e temës së diplomës duke realizuar takime periodike, udhëzuese duke ndjekur hap pas hapi ecurinë, qysh nga përcaktimi i stukturës së temës e duke bërë sugjerimet në ndihmë të studentit.</p> <p>Studenti nuk mund të dorëzojë temën apo të bëjë mbrojtjen e saj pa marrë me parë vlerësimin e pedagogut udhëheqës.</p> <p><u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</i></u> <u><i>Aneksi shtese 01 Udhëzim për përgatitjen e temes se diplomes</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo</p>	<p>Për raste kur temat e diplomës duhet të mbështeten nga studime, për të cilat nevojiten të dhëna që duhen analizuar, studentët orientohen e mbështeten nga TBU për mbledhje informacioni, apo analizim informacioni, duke vënë në dispozicion mjediset e Fakultetit, laboratorët, por dhe duke u ndjekur e udhëzuar gjatë</p>




<p>jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>gjithë kohës nga pedagogët udhëheqës të tyre. Temat e diplomës mund të përgatiten edhe në funksion të një punimi shkencor që do paraqitet në konferencat shkencore që organizon fakulteti, ku studenti mund të bashkëpunojë e të dalë me një punim shkencor, me pedagogun udhëheqës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p><i><u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU;</u></i> <i><u>Aneksi shtese 01 Udhezim për përgatitjen e temes se diplomes</u></i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas RVB dhe Rregullores së sekretarisë neni 3/E Për diplomimin, pavarësisht formës se diplomimit, me provim formimi apo diplomë, studenti në cdo rast vlerësohet me notë dhe përfiton 6 kredite ETCS.</p> <p><i><u>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</u></i> <i><u>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore.pdf</u></i> <i><u>Aneksi shtese 13 Model flete vleresues diplomim me teme;</u></i> <i><u>Aneksi shtese 14 Model flete vleresues diplomim provim formimi</u></i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas RVB dhe Rregullores së sekretarisë, neni 3/E, sekretaria mësimore pasi merr dokumentin përfundimtar të jurisë së mbrojtjes së diplomave plotëson regjistrin e notave edhe me këtë vlerësim dhe fillon përgatitjen e plotësimit të diplomave dhe suplementin e diplomës për çdo student. Ky proces mbikëqyret dhe kontrollohet nga dekanati i çdo fakulteti përpara se të firmoset nga rektori. Sipas dokumentacionit në përfundim të studimeve cdo student pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, sipas VKM nr 41, datë 24.01.2028.</p> <p><i><u>Aneksi 0.2 TBU RVB Programi bachelor AB final.pdf</u></i> <i><u>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore.pdf</u></i> <i><u>Aneksi 15.1 Modeli i diplomes dhe Urdheri i aprovimit Bch AB</u></i> <i><u>Aneksi 15.2 Modeli suplementi diplomes</u></i></p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Përveç diplomës dhe suplementit, me kërkesë të studentit, atij mund t'i jepet edhe i gjithë programi i studimit që ka zhvilluar në TBU.</p> <p><i><u>Aneksi 15.1 Modeli i diplomes dhe Urdheri i aprovimit Bch AB</u></i> <i><u>Aneksi 15.2 Modeli suplementi diplomes</u></i></p>




<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion, vecanërisht në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi se institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me Rregulloren për Sekretarinë Mësimore. Në përputhje me këtë legjislacion studentit pajiset sipas kërkesës së tij me informacione specifike si dhe me kopjen zyrtare të programit të studimit të tyre. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studenteve kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><u><i>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore</i></u> <u><i>Aneksi shtese 19 Rregullore për arkivin.pdf</i></u> <u><i>Aneksi 48 Politikat Institucionale Te Publikimit Te Informacionit</i></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në Tirana Business University College, GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të përditësuara për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi, personelin ndihmës-akademik dhe administrativ.</p>




<p>personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Financës është struktura përgjegjëse për menaxhimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave për personelin në formatin e dosjeve personale.</p> <p>Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale, GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar nga insitucioni.</p> <p>Angazhimet specifike të secilit anëtar të personelit akademik për çdo vit akademik specifikohen në kontratën e punës dhe ruhen nga njësia përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final;</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti (Neni 38&39);</i></u> <u><i>Aneksi 44 Formati i dosjes personale të stafit;</i></u> <u><i>Aneksi Tabelat permbledhese per Aneks RVB.(f.8-13, fq.18-22 & fq.41-55)</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e TBU.</p> <p>Procedurat dhe kriteret përkatëse për rekrutimin e personelit paraqiten në rregulloren përkatëse të punësimit hartuar nga TBU, e cila gjendet e publikuar edhe në faqen zyrtare të ëeb të universitetit.</p> <p><u><i>Aneksi 2 TBU statuti (Neni 34);</i></u> <u><i>Aneksi 11 Rregullore e punesimit. (Neni 4&5);</i></u> <u><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb. (link-u nr.16).</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret specifike të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë qe ben kerkesen per personel dhe miratohen nga Dekani, ku më pas përcillen për miratim tek Rektori i universitetit.</p> <p>Rregullorja e punësimit përcakton procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Në rastin e rekrutimit të personelit akademik komisioni i vlerësimi përbëhet nga përfaqësues të departamentit, të fakultetit dhe të TBU. Për kandidatë që janë figurë e njohur me ekspertizë shumë të vlefshme, drejtuesit e njësive bazë paraqesin propozimin për punësimin e tyre tek Rektori i TBU.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret specifike të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë qe ben kerkesen per personel dhe miratohen nga Dekani, ku më pas përcillen për miratim tek Rektori i universitetit.</p> <p>Rregullorja e punësimit përcakton procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Në rastin e rekrutimit të personelit akademik komisioni i vlerësimi përbëhet nga përfaqësues të departamentit, të fakultetit dhe të TBU. Për kandidatë që janë figurë e njohur me ekspertizë shumë të vlefshme, drejtuesit e njësive bazë paraqesin propozimin për punësimin e tyre tek Rektori i TBU.</p>




	<p>Nga takimet, GVJ konstatoi se një pjesë e personelit të punësuar në TBU, sidomos për persona që janë të kualifikuar dhe të njohur për eksperiencën që mbartin, është realizuar bazuar tek njohjet personale që kanë drejtuesit e institucionit duke evituar në këtë mënyrë që të ndiqen të gjitha hapat e procedurës standarde të punësimit.</p> <p>Procedura e konkurrimit dhe përzgjedhja e personelit ndihmës-akademik dhe atij administrativ bazohet në Kodin e Punës. Sidoqoftë, GVJ nuk mundi të verifikonte sesi këto procedura aplikoheshin, kush aplikonte, si bëhej vlerësimi i tyre dhe si përzgjidhej apo nëse bëheshin publike këto procedura, <i>GVJ nuk konstatoi mekanizma të bërjes publike të këtyre kriterëve.</i></p> <p><u>Aneksi 2 TBU statuti (Neni 34&36):</u> <u>Aneksi 11 Rregullore e punësimit (Neni 5&10).1</u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi.</p> <p>Mjediset në të cilat zhvillohen aktivitetet mësimore, kërkimore dhe administrative, të këtij programi studimi janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</u> <u>Aneksi 42 Mjediset e Fakultetit AB.;</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” administrohet nga Fakulteti i Administrim Biznesit, si njësi kryesore që ofron këtë program studimi, është i organizuar në</p>




<p>zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>tre departamente: Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, Departamenti i Kontabilitet Financë, Departamenti i Manaxhimit. Me synimin e një organizimi sa më efikas dhe sa më eficient të mësimdhënies dhe punës kërkimore, personeli i secilit departament organizohet në grupe me karakter mësimor dhe në grupe me karakter kërkimor-shkencor.</p> <p>Bazuar në informacionet e dosjes së vetëvlerësimit GVI konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e TBU për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik nëpërmjet përfshirjes në marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me institucione partnere ndërkombëtare dhe kombëtare në nivel kërkimi, mësimdhënieje dhe projekte të ngjashme.</p> <p>Vëmendja e TBU për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit shprehet qartë si në strategjinë e kërkimit shkencor të institucionit edhe në planin strategjik të zhvillimit të programit të studimit në fjalë.</p> <p><i>GVI sugjeron ngritjen e sistemeve motivuese e stimuluese të pjesëmarrjes në konferenca nderkombëtare prestigjioze apo botimet në revista shkencore prestigjioze të fushës së ekonomisë.</i></p> <p><u><i>Aneksi 43 Të dhena kerkimi shkencor stafi akademik.</i></u> <u><i>Aneksi Tabelat permbledhese per Aneks RVB. (Tabela no.6);</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti (Neni 8&40).</i></u> <u><i>Aneksi 3.2 TBU Strategjia e kerkimit shkencor 2018 (fq.2-4);</i></u> <u><i>Aneksi 4 Plani strategjik bachelor AB 2018-2021. (fq.7-8);</i></u> <u><i>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU. (Neni 5).</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Duke iu referuar informacioneve të dosjes së vetëvlerësimit si dhe informacionit të marrë në takimin me personelin akademik të programit të studimit, GVI konstatoi se personeli i angazhuar në këtë program studimi në kuadrin e projekteve të ndryshme të bashkëpunimit me universitete partnere, ka përfituar mobilitete me synim mësimdhënien të cilat kanë mundur kualifikime edhe për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjive të reja.</p> <p>Institucioni krijon mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin (si, videoprojektorët, disponibiliteti i shërbimit të internetit etj.) dhe vendosjen në dispozicion të materialeve udhëzuese në përdorimin e metodave inovative, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm komunikimin e shpejtë dhe efektiv me studentët.</p>




	<p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.:</u> <u>Aneksi 39 Udhëzim për zhvillimin përdorimin metoda inovative mesimdhenies</u> <u>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit;</u></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se aktualisht personeli akademik me kohë të plotë, mbulon mesatarisht 2-3 lëndë në këtë program studimi. Në takimin gjatë vizitës në institucion, personeli akademik dëshmoi se ngarkesa aktuale ishte mëse e përballueshme dhe nuk cënonte realizimin cilësor të objektivave të programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</u> <u>Aneksi 24 Te dhena tabelore personeli akademik i programit.</u> <u>Aneksi 25 Te dhena tabelore ngarkesa e plote stafi akademik</u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

<p>Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se institucioni ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Të dhënat për mjediset në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë Fakultetit të Administrim Biznesit që ofron programin në fjalë paraqiten si vijon:</p>




	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="647 174 932 219">Mjedisi - FEA</th> <th data-bbox="932 174 1339 219">Nr. Sallash</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="647 219 932 264">Salla leksioni</td> <td data-bbox="932 219 1339 264">5</td> </tr> <tr> <td data-bbox="647 264 932 309">Salla seminari</td> <td data-bbox="932 264 1339 309">4</td> </tr> <tr> <td data-bbox="647 309 932 434">Bibliotekë/ Laborator informatike</td> <td data-bbox="932 309 1339 434">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="647 434 932 645">Ambiente ndihmëse</td> <td data-bbox="932 434 1339 645"> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Librari/fotokopje ▪ Zyrë informacioni ▪ Zyrës per Koordinim dhe Mbështjen ndaj Studentëve </td> </tr> <tr> <td data-bbox="647 645 932 855">Mjedise shlodhëse si lojë shahu/kuba, shërbime kafeterie/katering, etj</td> <td data-bbox="932 645 1339 855">3</td> </tr> </tbody> </table>	Mjedisi - FEA	Nr. Sallash	Salla leksioni	5	Salla seminari	4	Bibliotekë/ Laborator informatike	1	Ambiente ndihmëse	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Librari/fotokopje ▪ Zyrë informacioni ▪ Zyrës per Koordinim dhe Mbështjen ndaj Studentëve 	Mjedise shlodhëse si lojë shahu/kuba, shërbime kafeterie/katering, etj	3
Mjedisi - FEA	Nr. Sallash												
Salla leksioni	5												
Salla seminari	4												
Bibliotekë/ Laborator informatike	1												
Ambiente ndihmëse	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Librari/fotokopje ▪ Zyrë informacioni ▪ Zyrës per Koordinim dhe Mbështjen ndaj Studentëve 												
Mjedise shlodhëse si lojë shahu/kuba, shërbime kafeterie/katering, etj	3												
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe informacionin e siguruar nga takimi me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të javës, në 3 kate të godinës së TBU, në 3 fasha orare 9:00; 14:00;17: 30.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.(Standardi III.3-Kriteri nr.3 & Standardi IV.3-Krireri nr.1);</i></u> <u><i>Aneksi shtese 15 Raporti inspektimit të kapaciteteve MASR 19-20.</i></u> <u><i>Aneksi 42 Mjediset e Fakultetit AB</i></u> <u><i>Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit.</i></u></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se të gjitha mjediset mësimore në të 3 katet e godinës së TBU, janë të pajisura me pajisje të teknologjisë së informacionit që garantojnë lidhjen me internet përmes kabëll-it, krahas internetit ëireless që mbulon të gjitha mjediset e shkollës.</p> <p>Sallat e leksionit dhe klasat e seminareve janë të pajisura me videoprojektorë desktop/laptop, tabelë dhe flipcharter si dhe me bokse (audio).</p> <p>Në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” është laborator i informatikës, i cili gjendet i vendosur në mjediset e bibliotekës. Në këtë sallë janë</p>												




<p>mësimdhënies- mësimnxënies.</p>	<p>instaluar 35 kompjutera në dispozicion të studentëve. Studentët, përveç orëve të mësimit në lëndët që kanë lidhje me IT, mund ta përdorin këtë laborator çdo ditë të javës për të kryer detyra të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB inal (Standardi III.3-Kriteri nr.7)</i></u> <u><i>Aneksi shtese 15 Raporti inspektimit të kapaciteteve MASR 19-20</i></u> <u><i>Aneksi 42 Mjediset e Fakultetit AB.</i></u> <u><i>Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit</i></u> <u><i>Aneksi 3.2 TBU strategjia e kerkimit shkencor 2018.p (fq.3-4);</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe informacionit të marrë gjatë takimeve në TBU, GVJ konstatoi se institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale në përputhje me kërkesat e parashikuara në programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”.</p> <p>Mundësia e kryerjes së praktikës profesionale për studentët është siguruar si rezultat i rrjetit të gjerë të bashkëpunimit të TBU me 120 subjekte të konsoliduara dhe i 41 marrëveshjeve të bashkëpunimit me sipërmarrje private, institucione publike, organizata jo-fitimprurëse. Për këtë arsye çdo student mund të sigurojë mesatarisht 15-20 njoftime për praktika profesionale apo pune çdo muaj. Angazhimi i studentëve bachelor në praktikat profesionale fillon që në vitin e parë të programit, ku përgjatë tre viteve studimore mund të arrijë 12 muaj ose më shumë. Fleksibiliteti i orarit mësimor lehtëson këtë angazhim profesional. Ky lloj organizimi ka rezultuar i suksesshëm nga viti në vit në punësimin e studentëve të TBU.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU. (Neni 25);</i></u> <u><i>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab. (Neni 9);</i></u> <u><i>Aneksi 17. Studimi per tregun e punes, Janar 2020.</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	




	<p><u>Aneksi 29 të dhena tabelore permbledhese per punesimin real të studentëve.</u></p> <p><u>Aneksi 32 Tabele permb. institucionet bashkepunuese</u></p> <p><u>Aneksi 34 TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione të ndryshme.</u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se TBU vë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe personelit të tij një bibliotekë modeste me fond fizik. Biblioteka ndodhet në katin e 3 të TBU dhe ka një sipërfaqe 128 m².</p> <p>Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të studimit si: tekste mësimore bazë dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj; libra, periodikë, botime të institucioneve të tjera si dhe arkiva e temave të dipomës. Biblioteka mund të shfrytëzohet nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit çdo ditë të javës.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final. (Standardi III.3-Kriteri nr.4 & Standardi IV.4 – Kriteri 1 & 2);</u></p> <p><u>Aneksi 45 Database e teksteve Biblioteka.</u></p> <p><u>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit</u></p> <p><u>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb (link-u nr.16);</u></p> <p><u>Aneksi Tabelat permbledhese per Aneks RVB (Tabela no.17);</u></p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-	Në takimi me stafin akademik dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se TBU nga viti 2014 rezulton të jetë e abonuar në librarinë virtuale EBSCO në kategorinë e biznesit. Kjo librari online vendos në dispozicion të studentëve dhe personelit




line të fushës së programit të studimit.	akademik mbi 40,000 artikuj dhe libra (Business Source Complete, Business Source Ultimate, Harvard Business Review & Press e-books) cilësor.			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>TBU i siguron studentëve dhe personelit akademik e administrativ akses të barabartë dhe të lirë në EBSCO.</p> <p>Përmes adresave elektronike përkatëse (adresës IP të shkollës apo si përdorues personal (passëord/admin) studentët mund të kërkojnë për artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së tyre të interesit. Salla e bibliotekës është e pajisur me teknologjinë e nevojshme kompjuterike e cila i mundëson studentëve dhe pedagogëve një kërkim më të lehtë dhe cilësor.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final. (Standardi III.3-Kriteri nr.4,6 & Standardi IV.4 – Kriteri 3 & 4);</u></p> <p><u>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit.</u></p> <p><u>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb (link-u nr.16);</u></p> <p><u>Aneksi Tabelat permbledhese per Aneks RVB. (Tabela no.17);</u></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet me personelin në ambientet e bibliotekës në TBU, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në shtimin dhe përditësimin e fondit të bibliotekës dhe i ka përfshirë këto objektiva në planin e bibliotekës.</p> <p>GVJ konstatoi se oraret e shërbimit të bibliotekës (çdo ditë të javës nga ora 9:00 - 21.00) janë në përputhje me nevojat e studentëve të këtij program studimi, por edhe të studentëve të tjerë të TBU.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final (Standardi III.3-Kriteri nr.4,6 & Standardi IV.4 – Kriteri nr.1)</u></p> <p><u>Aneksi shtese 16 Plani per Biblioteken</u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>




Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se Sekretaria Mësimore është struktura që administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi.</p> <p>Gjatë takimit me sekretarinë GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen fizike të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” dhe konstatoi plotësinë e tyre si dhe përdorimin e regjistrave përkatës (themeltar & të arritjeve akademike) sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Të gjitha informacionet mbi aktivitetin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim ruhen në arkivën e TBU në format letër (regjistrat) dhe elektronik. Kjo arkivë ndodhet nën kujdesin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 30);</i></u> <u><i>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore.</i></u> <u><i>Aneksi shtese 19 rregullore per arkivin.</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” realizohet nga disa struktura në varësi të natyrës së informacionit.</p> <p>Secili Departament i Fakultetit të Administrimit të Biznesit menaxhon dokumentacionin lidhur me aktivitetin mësimor dhe kërkimor të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në fjalë. Zyra e Financës administrojnë dosjet e plota personale të të gjithë personelit të TBU si dhe informacionin lidhur me pagat e personelit, fondet për kërkimin shkencor dhe çështje të tjera financiare. Informacioni në dosjet personale përditësohet rregullisht për të reflektuar ndryshimet e ndodhura në kualifikime, pozicione etj.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti.</i></u> <u><i>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU;</i></u></p>



	<p><u>Aneksi 11 Rregullore e punesimit.</u></p> <p><u>Aneksi 49 Te dhena nga raporti financiar vjetor.</u></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit dhe në informacionin e marrë gjatë takimeve të realizuara në TBU, GVJ konstatoi se Institucioni është duke punuar për të vendosur në dispozicion të studentëve dhe personelit një sistem online interaktiv (Sistemi i Menaxhimit të Studentëve). Ky sistem do t'i shërbejë studentëve për t'i informuar rreth aktiviteteve dhe proceseve që lidhen me programin e studimit (si aksesimi i notave, i materialeve mësimore, ecuria e pagesave, komunikimi me personelin, etj.), ndërsa personelit akademik do t'i shërbejë për të depozituar materiale ndihmëse si dhe për të komunikuar me studentët dhe strukturat e tjera të TBU. Gjithashtu, nëpërmjet aplikacioneve Google Drive, Dropbox dhe Google Classroom personeli akademik jo vetëm komunikon në mënyrë interaktive me studentët, por i përdor këto aplikacione edhe për të pasqyruar informacione të detajuara lidhur me lëndët që mbulon secili prej tyre.</p> <p>Përveç sistemit online interaktiv, TBU pajis studentët dhe personelin akademik e administrativ me adresë personale email-i dhe ofron asistencë teknike për përdorimin e tyre.</p> <p>Krahas platformës dhe aplikacioneve online, TBU, nëpërmjet Sekretarisë Mësimore informon rregullisht studentët dhe personelin akademik për aktivitete që lidhen me programin mësimor dhe të tjera.</p> <p>Në tërësi TBU, nëpërmjet platformës dhe sistemit online, garanton monitorim in e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson raportime në kohë reale për strukturat përkatëse.</p> <p><i>GVJ sugjeron implementimin e një sistemi informacioni të integruar, për menaxhimin e bazës të të dhënave për studentët, për vlerësimet e tyre dhe që vetë studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre të kenë informacion në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive. Gjithashtu ky sistem informacioni mund të shërbejë për manaxhimin e gjithë data bazës në vite për stafin akademik, ndihmës akademik, personelit administrativ, duke nisur që prej procedurave të konkurrimit, seleksionit, rekrutimit, ndryshimet vit mbas viti etj</i></p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</u></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	




	<p><i>Aneksi 2 TBU statuti. (Neni 52&53);</i> <i>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit;</i> <i>Aneksi Tabelat përmbledhese për Aneks RVB. (Tabela no.17)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare ëeb të TBU publikohet në gjuhën shqipe dhe angleze informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbime e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb. (Link nr.17 - https://tbu.edu.al/al/programet/programe-bachelor dhe link nr.18 - http://tbu.edu.al/al/programet/stafi-akademik); http://tbu.edu.al/)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit, GVJ konstatoi se institucioni në raportin financiar vjetor institucional që harton paraqet kostot e programeve të studimit dhe planin për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi.</p> <p>Bazuar në tabelën e të ardhurave dhe financimeve të ndryshme për 3 vitet e kaluara akademike dhe parashikimet për 5 vitet e ardhshme, rezulton se programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” financohet vetëm nga tarifat e regjistrimit dhe studimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet</p>	<p>Të ardhurat nga viti në vit kanë pësuar rritje si rezultat i rritjes së numrit të studentëve në këtë program studimi. Bazuar në tabelën e shpenzimeve për 3 vitet e kaluara akademike dhe parashikimet për 5 vitet e ardhshme, rezulton se shpenzimet e këtij programi studimi kanë pësuar rritje si rezultat i rritjes së numrit të studentëve në këtë program studimi. Duke vendosur në krahasim të ardhurat dhe shpenzimet e programit për 2 vitet e kaluara akademike, vëmë re se të ardhurat nga tarifat e studimit mbulojnë shpenzimet e këtij programi. Në nivel institucional rezulton të jetë prioritet në objektivat e strategjisë për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”.</p>

<p>financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Treguesi kosto për një student për vitin 2018 rezulton 141,043 lekë ndërsa për vitin 2019 rezulton 140,760 lekë. Treguesi e ardhura për student për vitin 2018 rezulton 144,510 lekë, ndërsa për vitin 2019 rezulton 142,209 lekë.</p> <p>Sipas Statutit të TBU, buxheti hartohet dhe zbatohet në përputhje me statutin dhe ligjin për arsimin e lartë në fuqi (L. 80/2015, Neni 108). Me propozim të Senatit, Bordi i Administrimit miraton tarifat e studimit, llojet e bursave studentore dhe kriteret e përfitimit të tyre, pagesat e personelit dhe çdo çështje tjetër financiare.</p> <p>Të ardhurat, klasifikuar sipas burimeve të parashikuara të financimit (tarifat e regjistrimit dhe studimit, shërbime në përputhje me objektivin e veprimtarisë, kontribute të ortakëve dhe donacione të tjera), do të vazhdojnë të krijohen nga tarifat e studentëve. Në parashikimin për 5-vitet e ardhshme vëmë re se shpenzimet e programit, klasifikuar kryesisht sipas natyrës së tyre (shpenzimet për personel akademik dhe jo akademik, qera dhe shpenzime operative etj.), do të vazhdojnë të mbulohen nga tarifat e studentëve.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</u> <u>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 52&53)</u> <u>Aneksi 4 Plani strategjik bachelor AB 2018-2021 (Pika nr.V);</u> <u>Aneksi 49 Te dhena nga raporti financiar vjetor.</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas Statutit, kontrolli dhe auditimi i brendshëm në institucion realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm e këtij institucioni, e cila ngrihet dhe funksionon me vendim të Bordit të Administrimit të TBU. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, TBU kryen auditim të përvitshëm ku vlerëson gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar, por bazuar në dosjen e vetëvlerësimit të paraqitur nga institucioni nuk gjendet një reference që mbështet një konfirmim të tillë.</p> <p>Gjithashtu, sipas statutit, TBU është objekt i auditimit të jashtëm nga audituesi i pavarur Net-SFS Kreston Sh.p.k. Ky process auditim zhvillohet në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë në fuqi (L. 80/2015, Neni 116, Pika 2). Audituesi i jashtëm përzgjidhet nga Bordi i Administrimit të TBU-së.</p> <p>Bazuar në të dhënat nga Raporti financiar vjetor institucional në lidhje me kostot e programit të studimit në fjalë, GVJ konstatoi se institucioni analizon të ardhurat dhe shpenzimet për 3 vitet e kaluara akademike dhe për 5 vitet e ardhshme.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</u> <u>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 54);</u> <u>Aneksi shtese 17 Raporti i Audituesit të Pavarur 2018.</u> <u>Aneksi 49 Te dhena nga raporti financiar vjetor</u></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Bazuar në të dhënat nga Raporti financiar vjetor institucional në lidhje me kostot e programit të studimit në fjalë, GVJ konstatoi se institucioni analizon të ardhurat dhe shpenzimet për 3 vitet e kaluara akademike dhe për 5 vitet e ardhshme.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</u> <u>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 54);</u> <u>Aneksi shtese 17 Raporti i Audituesit të Pavarur 2018.</u> <u>Aneksi 49 Te dhena nga raporti financiar vjetor</u></p>




<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Sipas statutit, burimet e financimit të TBU janë: tarifat e regjistrimit dhe studimit, shërbime në përputhje me objektivin e veprimtarisë, kontribute të ortakëve dhe donacione të tjera.</p> <p>Bazuar në të dhënat nga Raporti financiar vjetor institucional në lidhje me kostot e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi, GVJ konstatoi se për periudhën 2016-2019 ecuria e të ardhurave të realizuara nga tarifat e studentëve për programin në fjale ka ardhur në rritje. Gjithashtu, bazuar tek parashikimi i realizuar për 5 vitet e ardhshme konstatohet një rritje e qëndrueshme e të ardhurave.</p> <p><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</i> <i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 52):</i> <i>Aneksi 49 Te dhena nga raporti financiar vjetor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e TBU, si dhe informacionin e faqes ëeb zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</p> <p>Barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit pasqyrohen në nenet specifike të Statutit të TBU, Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesit Mesimor, si dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet mbi bazën e kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme për secilin</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë</p>	




<p>dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>program. Kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Rektori i TBU.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dosjen e vetëvlerësimit dhe në faqen e ëeb-it të TBU, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u></p> <p><u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 8, pika 7; Neni 30; Neni 31; & Neni 32);</i></u></p> <p><u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU. (Neni 2);</i></u></p> <p><u><i>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab.</i></u></p> <p><u><i>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore.</i></u></p> <p><u><i>Aneksi shtese 01 Udhezim për përgatitjen e temes se diplomes.</i></u></p> <p><u><i>Aneksi shtese 10 Rregullore për mbarëvajtjen e procesit mësimor</i></u></p> <p><u><i>Aneksi shtese 18 Rregullore e praktikes mesimore</i></u></p> <p><u><i>Aneksi https://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit-2019-2020;</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit GVJ konstatoi se TBU harton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për pranim sipas secilit program dhe cikël studimesh përpara çdo fillim viti akademik.</p> <p>Kriteret e përgjithshme të pranimit të një kandidati për student në një program studimi përcaktohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Kriteret e veçanta përcaktohen në rregulloren e programit përkatës në të cilin kandidati kërkon të regjistrohet ose me vendim të Senatit Akademik. Përpara fillimit të vitit akademik, Departamentet/ Njesitë Bazë përgjegjëse për Programin e Studimit, propozojnë kriteret e veçanta të pranimit të studentëve për secilin program studimi. Këto kriteret më pas miratohen nga Rektori i TBU. Kriteret e pranimit të studentëve për secilin program janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të ëeb-it të TBU.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe Rregulloret e TBU, sidomos mbi programet e studimit, nuk gjejmë të pasqyruara kriteret për regjistrimin e studentëve me shtetësi të huaj në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MASR për ndjekjen e studimeve në ciklin bachelor.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe Rregulloret e TBU, sidomos mbi programet e studimit, nuk gjejmë të pasqyruara kriteret për regjistrimin e studentëve me shtetësi të huaj në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MASR për ndjekjen e studimeve në ciklin bachelor.</p>




<p>publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se TBU luan një rol mjaft aktiv në informimin e të gjithë të interesuarve në lidhje me Institucionin, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to. TBU, nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Zyrës së Karrierës dhe Punësimit organizon takime informuese të drejtpërdrejta me maturantët e shkollave të mesme të vendit, ku prezanton ofertën e saj akademike dhe programet e studimit bachelor. Gjithashtu, organizon konkurse kombëtare me maturantët, si dhe mban lidhje dhe mbështet aktivitete me shkollat e mesme. Këto aktivitete dhe njoftime të tjera në interes të këtij target grupi publikohen dhe promovohen në faqen zyrtare të ëeb-it të TBU dhe në media sociale.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 32);</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU. (Neni 2);</i></u> <u><i>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU. (Neni 4);</i></u> <u><i>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab.(Neni 11);</i></u> <u><i>Aneksi 12 Rregullore Zyra e Karrieres TBU. (Neni 5);</i></u> <u><i>Aneksi 51 TBU POLITIKA E MARKETINGUT.;</i></u> https://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit-2019-2020; http://tbu.edu.al/al/lajme/nxenesit-dhe-mesuesit-e-jaa-trajnohen-nga-pedagoget-tbu; http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/dite-informuese; http://tbu.edu.al/al/programet/konkursi-kombetar-me-maturantet</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare të ëeb-it të TBU, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve</p>




<p>procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Konkretisht GVJ konstatoi që kriteret lidhur me pranimin e studentëve në programet e studimit, regjistrimin e studentëve, kushtet e kalimit në vitet pasuese deri në diplomim, transferimi i krediteve, etj, janë pjesë e rregulloreve për programet e studimit dhe të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” të publikuara në faqen ëeb zyrtare të TBU.</p> <p>Gjithashtu, studentët informohen në lidhje me programin e studimit në fjalë, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në fillim të vitit akademik si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik dhe administrative i TBU-së.</p> <p>Në TBU, studentët që vijnë nga universitete të tjera me transferim, pranohen për të ndjekur studimet vetëm nëse ata përmbushin kriteret e vendosura për këtë qëllim. Vendimin për njohjen e krediteve dhe të programit të studimit që duhet të ndjekë studenti në TBU në përputhje me L-AL, merret nga komisioni përkatës i ngritur nga njësia bazë përkatëse.</p> <p><u><i>Aneksi RVB Programi bachelor AB final. (Standardi III.5 & Standardi III.8);</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 50);</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU(Neni 2 & 32);</i></u> <u><i>Aneksi shtese 20 Shembull Vendim ekuivalentimi Bch AB.</i></u> <u><i>http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/pyetje-te-shpeshta-rreth-tbu;</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores për programet e studimit dhe rregullores së programit në fjalë, syllabuseve të lëndëve dhe prezantimit të pedagogut përkatës në fillim të lëndës, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse e programit përpara fillimit të semestrit të 6-të njofton me email studentët për formën e diplomimit dhe afatet përkatëse. Mbrojtja e diplomës për programet e ciklit të parë të studimeve sipas L-AL bëhet nëpërmjet një provimi përfundimtar formimi ose përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome (mikroteze). Studentët që fitojnë të drejtën të diplomohen me temë diplome, duhet të plotësojnë kriterin me</p>




	<p>notë mesatare mbi 7 (shtatë). Në rastin e diplomimit me provim, Komisioni i ngritur me miratim nga Dekani i Fakultetit të Administrim Biznesit për administrimin e procesit të provimit përfundimtar, përgatisin raste studimi në përputhje me profilin përkatës. Në rastin e punimit të diplomes, përgjegjësit e departamenteve përkatëse, me fillimin e semestrit të gjashtë, miratojnë temat e diplomës për çdo student Bachelor dhe udhëheqësin përkatës. Tema e diplomës përgatitet në përputhje me udhezimin përkatës.</p> <p>Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit është kusht i domosdoshëm për të vijuar me procesin e diplomimit.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final. (Standardi III.5-1, Reference: III.6-1 & III.8-1,2,3);</i></u> <u><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lëndëve Bachelor AB</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU. (Neni 16-17,27-28);</i></u> <u><i>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore. (Pika A.3.);</i></u> <u><i>Aneksi shtese 01 Udhezim për përgatitjen e temes se diplomes (Pika 5&6);</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti (Neni 18,Pika 4& Neni 24, Pika 10</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se TBU luan një rol mjaft aktiv në informimin e të gjithë të interesuarve në lidhje me Institucionin, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to. TBU, nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Zyrës së Karrierës dhe Punësimit organizon takime informuese të drejtpërdrejta me maturantët e shkollave të mesme të vendit, ku prezanton ofertën e saj akademike dhe programet e studimit bachelor. Gjithashtu, organizon konkurse kombëtare me maturantët, si dhe mban lidhje dhe mbështet aktivitete me shkollat e mesme. Këto aktivitete dhe njoftime të tjera në interes të këtij target grupi publikohen dhe promovohen në faqen zyrtare të ëeb-it të TBU dhe në media sociale.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 32);</i></u> <u><i>Aneksi 12 Rregullore Zyra e Karrieres TBU. (Neni 5);</i></u> <u><i>Aneksi 51 TBU - POLITIKA E MARKETINGUT.</i></u> <u><i>http://tbu.edu.al/al/lajme/nxenesit-dhe-mesuesit-e-jaa-trajnohen-nga-peda-goget-tbu;</i></u> <u><i>http://tbu.edu.al/al/programet/ konkursi-kombetar-me-maturantet;</i></u></p>




	http://tbu.edu.al/al/lajme/22-shkurt-2020-trajnim-dedikuar-maturanteve; http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/pyetje-te-shpesh-ta-rreth-tbu;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare të ëeb-it të TBU, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” informohen nga pedagogët përkatës dhe sekretaria mësimore për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Gjithashtu, studentët këshillohen individualisht në përzgjedhjen e profilit të programit të studimit në fjalë.</p> <p>Informacionin në lidhje me organizimin dhe strukturën e programit të studimit, studentët e gjejnë të aksesueshëm edhe në distance në faqen zyrtare të ëeb-it të TBU.</p> <p><i><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</u></i> <i><u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU. (Kreu III);</u></i> <i><u>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab. (Neni 4-6, Neni 12 & Neni 13);</u></i> <i><u>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore. (Pika B.1.);</u></i> <i><u>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 30, Pika 3)</u></i> https://tbu.edu.al/al/programet/pro-grame-bachelor;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Zyra e Karrierës dhe Punësimit (ZKP) ishte struktura që kujdesej kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit përpara përfundimit të studimeve.</p>




	<p>Kjo zyrë në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të TBU, informon, orienton dhe mbështet studentët duke krijuar mundësi për realizimin e praktikave dhe trajnimeve të ndryshme, duke lehtësuar komunikimin me tregun e punës si edhe duke ndjekur ecurinë e tyre pas diplomimit. ZKP mban kontakte të vazhdueshme me subjektet partnere dhe informon studentët për mundësitë që ata ofrojnë. Gjithashtu, ajo luan rol në ndërmjetësimin e intervistave të punës për studentët.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 12 Rregullore Zyra e Karrieres TBU. (Neni 4 & 5);</i></u> <u>http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/partneret;</u> <u>https://tbu.edu.al/al/studentët/zyra-e-punesimit-dhe-karrieres;</u> <u>http://www.tbu.edu.al/al/studentët/studentë-karriere;</u> <u>http://www.tbu.edu.al/al/studentët/studentë-sipermarres</u> <u>https://tbu.edu.al/al/studentët/tbu-inkubatori-i-biznesit-studentor;</u> <u>http://tbu.edu.al/al/lajme/intervista-mundes-punesimi-prane-ëebprom</u> <u>http://tbu.edu.al/al/lajme/11-studentë-u-intervistuan-per-mundes-punesimi-nga-neë-medical-plus</u></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se pedagogët e departamenteve përkatëse, sekretaria mësimore dhe Zyra e Çështjeve Studentore, luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Monitorimi i strukturës së teknologjisë së informacionit në TBU udhëhiqet nga përgjegjësi i IT/Logjistikës.</p> <p>Nëpërmjet faqes web zyrtare të TBU, së shpejti edhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë për çdo informacion që lidhet me programin e studimit në fjalë.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final. (Standardi IV.5);</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU. (Neni 9,11,12,14 &15);</i></u></p>




	<p><u>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore (Pika B.);</u> <u>Aneksi 2 TBU statuti. (Neni 32,Pika 5;)</u> <u>Aneksi 46 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit.</u> http://tbu.edu.al/al/programet</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se TBU mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Konkretisht, Sekretaria Mësimore në bashkëpunim me Zyrën e Çështjeve Studentore, Zyrën e Karrierës dhe Punësimit (ZKP) dhe Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi. Gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim e gjejmë të pasqyruar edhe në raportet vjetore të TBU, kryesisht në seksionin e përgatitur nga Senati Akademik. Duke iu referuar këtyre statistikave në lidhje me këtë program studimi (2014-2020) rezulton se ka pasur 195 studentëve të ardhur me transferim studimesh nga IAL të tjera, ndërsa numri i




	<p>studentëve të çregjistruar nga programi rezulton të jetë 40 studentë (2017-2019).</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” dhe konstatoi plotësinë e tyre. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 4 vitet e fundit paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="639 472 1385 689"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2016-2017</td> <td>66 studentë</td> <td>47 studentë</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td>75 studentë</td> <td>74 studentë</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>86 studentë</td> <td>85 studentë</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>70 studentë</td> <td>Info në proces</td> </tr> </tbody> </table> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 27 - Pika 3, 30, 31&32)</i></u> <u><i>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore.</i></u> <u><i>Aneksi Rregullore Zyra e Karrieres TBU. (Neni 4 & 5);</i></u> <u><i>Aneksi 27 Cilesia në hyrje dhe dalje studentë Bch AB.;</i></u> <u><i>Aneksi 28 Te dhena per transferimet e studentëve. (Aneksi 27-Tab.21);</i></u> http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/raportet-vjetore;</p>	Viti akademik	Të regjistruar	Të diplomuar	2016-2017	66 studentë	47 studentë	2017-2018	75 studentë	74 studentë	2018-2019	86 studentë	85 studentë	2019-2020	70 studentë	Info në proces
Viti akademik	Të regjistruar	Të diplomuar														
2016-2017	66 studentë	47 studentë														
2017-2018	75 studentë	74 studentë														
2018-2019	86 studentë	85 studentë														
2019-2020	70 studentë	Info në proces														
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të TBU.</p> <p>Sekretaria Mësimore kujdeset për ruajtjen e informacionit në formatin letër (në arkivë fizike) dhe në versionin elektronik. Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si edhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</i></u> <u><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU. (Neni 13);</i></u> <u><i>Aneksi 9 Rregullore për sekretarinë mësimore. (fq.4);</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 30);</i></u> <u><i>Aneksi shtese 19 Regullore per arkivin</i></u></p>															
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare), si dhe</p>															




<p>cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>kalueshmërinë sipas lëndëve dhe programeve të studimit. Rezultatet krahasohen me objektivat e vendosura nga njësia bazë dhe aty ku është e mundur, merr masat për të kryer përmirësimet e nevojshme. Këto rezultate publikohen në raportet vjetore të TBU.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi Bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti (Neni 24, Pika 3);</i></u> <u><i>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU. (Neni 4);</i></u> <u><i>Aneksi 27 Cilesia në hyrje dhe dalje studentë Bch AB</i></u> <u><i>http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/raportet-vjetore;</i></u> <u><i>Aneksi 38 Analize e realizimit të objektivave Programi Studimit BachelorAb 18-19.</i></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se TBU në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e institucionit ka inkurajuar ngritjen e Këshillave Studentore, si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të TBU, në Komisionet e Cilësisë (në nivel insitucioni dhe nivel fakulteti) dhe në Komisionet për Marrëdhëniet me Studentët (në nivel insitucioni dhe nivel fakulteti), si dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se në statutin e TBU dhe rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në një proces transparent.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti (Neni 13, 26, 27.2, 28, 42);</i></u> <u><i>Aneksi 8 Rregullore e NJSBC. (Neni 4.2);</i></u></p>




<p>me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p><u><i>Aneksi 30 Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilesise</i></u> <u><i>Aneksi 40 Pyetesori i studentëve.</i></u> <u><i>S.6.1 bsc ab rezultatet anketimi.pdf;</i></u> <u><i>http://tbu.edu.al/ al/rreth-tbu/raportet-vjetore;</i></u> <u><i>https://tbu.edu.al/al/studentët/qeveria-studentore</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë gjatë takimit me personelin akademik të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, rezultoi se në hartimin dhe ndryshimet e bëra në vite për programin e studimit në fjalë, është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve. Gjithashtu, shpërndarja e krediteve dhe syllabuset e lëndëve (moduleve) janë të strukturuar në mënyrë të tillë që lehtësojnë procesin e transferimit të studentëve nga jashtë TBU.</p> <p>Përveç përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, përmes strukturave të garantuara nga statuti dhe rregulloret përkatëse, GVJ konstatoi se aktualisht institucioni përdor në fund të çdo semestri dhe viti akademik pyetësorin për studentët për të vlerësuar procesin mësimor, personelin akademik sipas lëndëve (moduleve) që ata ndjekin si dhe institucionin në tërësi. Rezultatet e pyetësorëve analizohen nga njësitë bazë përkatëse dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerr departamenti.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 42);</i></u> <u><i>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU. (Neni 4);</i></u> <u><i>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab. (Neni 14);</i></u> <u><i>Aneksi 8 Rregullore e NJSBC. (Neni 5.6, 9.3, 10.f);</i></u> <u><i>Aneksi 14.1 Plani mesimor Bachelor AB 19-20.</i></u> <u><i>Aneksi 38 Analize e realizimit të objektivave Programi Studimit BachelorAb 18-19.</i></u> <u><i>Aneksi 40 Pyetesori i studentëve.</i></u> <u><i>Aneksi shtese 20 Shembull vendim ekuivalentimi Bch AB.</i></u> <u><i>S.6.1 bsc ab rezultatet anketimi</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve,</p>	<p>Në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor parashikohet e drejta e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, brenda 3 ditëve nga marrja e rezultatit të provimit. Sekretaria njofton menjëherë pedagogun e lëndës në lidhje me ankesën, i</p>




<p>përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>cili shqyrton ankesën brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit. Vendimi i pedagogut të lëndës për notën është përfundimtar. Gjithashtu studentët mund të përdorin edhe pyetësonin përkatës për të shprehur mendimin e tyre lidhur me cilësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final. (Standardi III.6-8/9);</u> <u>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit TBU. (Neni 22);</u> <u>Aneksi 40 Pyetësoni i studentëve.</u> <u>S.6.1 bsc ab rezultatet anketimi</u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstatoi se në statutin dhe rregulloret e TBU parashikohen qartë procedurat dhe strukturat/zyrat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria Mësimore, Zyra e Çështjeve Studentore, Zyra e Karrierës dhe Punësimit (ZKP) dhe struktura të tjera të njesisë bazë.</p> <p>Këto zyra, pjesë përbërëse e strukturës organizative të institucionit, në bashkëpunim me njesinë bazë përgjegjëse për programin e studimit janë në shërbim të informimit dhe të shërbimit të studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Konkretisht, këto zyra në bashkëpunim me njesinë bazë përgjegjëse të programit ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtëpërdrejtë me procesin mësimor si dhe garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti, si dhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problemet dhe problematikat e lidhura me studentët.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</u> <u>Aneksi Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 30-8, 32);</u></p>




	<p><u>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazëTBU. (Neni 4);</u> <u>Aneksi 9Rregullore për sekretarinë mësimore.;</u> <u>Aneksi Rregullore Zyra e Karrieres TBU. (Neni 4 & 5);</u> <u>Aneksi shtese 05 Vendim percaktimi drejtuesve praktikes mesimore 2018-2019.</u></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe rregullores në lidhje me Zyrën e Karrierës dhe Punësimit (ZKP), rezultoi se shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga kjo zyrë. Zyra e Karrierës dhe Punësimit drejtohet nga një përgjegjës i cili emërohet nga Rektori i TBU. GVJ konstatoi se veprimtaria e kësaj zyre përfshinte sigurimin e informacioneve orientuese dhe ofrimin e zgjidhjeve për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës së studentëve potencialë dhe aktual të TBU si dhe gjurmimin e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Kjo zyrë ruan dhe mban kontakte të vazhdueshme me partnerët e biznesit të TBU. Për këtë arsye ZKP shërben si një nyje ndërlidhëse midis studentëve të TBU dhe partnerëve të tij të biznesit, duke mundësuar procesin e përputhjes së studentit me pozicionin më të përshtatshëm nga praktika profesionale deri tek punësimi i tij.</p> <p>Gjithashtu, ZKP luan një rol të rëndësishëm dhe në monitorimin, vlerësimin, dokumentimin dhe raportimin sistematik tek strukturat drejtuese të TBU në lidhje me punësimin e avancimin në karrierë të studentëve/alumni.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</u> <u>Rregullore Zyra e Karrieres TBU</u> <u>Aneksi 29 të dhena tabelore permbledhese per punesimin real të studentëve</u> https://tbu.edu.al/al/studentët/zyra-e-punesimit-dhe-karrieres;</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, statutit dhe rregulloreve të TBU, GVJ konstatoi se procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Përgjegjësia institucionale e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë i takon Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi kujdeset për sigurimin e cilësisë në të gjitha njësitë e TBU. Njësia e Sigurimit të Cilësisë ka në përbërjen e saj tre anëtarë (njëri nga anëtarët është pjesë e Qeverisë Studentore), të cilët përzgjidhen nga Senati Akademik. Në nivel institucioni dhe fakulteti organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë dhe të Marrëdhënive me Studentët me anëtarë të personelit akademik (3 anëtarë) si dhe me përfaqësues nga studentët (2 anëtarë).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon si një organ i pavarur operativ në përputhje me Rregulloren e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar “TBU”, ndërsa Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë funksionojnë në përputhje me Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Organeve Kolegjiale në TBU. Në planin strategjik të zhvillimit të TBU një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë në përmirësimin e programeve e metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me standarde Europiane, për të përgatitur studentët për të konkurruar në jashtë vendit. Në arritjen e këtij objektivi përfshihen edhe rekomandimet nga ekspertë të huaj. <u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 27&28);</i></u> <u><i>Aneksi 3.1 TBU strategjia e zhvillimit 2018. (fq.7);</i></u> <u><i>Aneksi 7 Rreg progr stud bach ab. (Neni 14);</i></u> <u><i>Aneksi 8 Rrregullore e NJSBC.</i></u> <u><i>Aneksi 30 Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></u>



	<p><u><i>Aneksi shtese 09 Rregullore për funksionimin e organeve kolegjiale.</i></u></p> <p><u><i>Aneksi shtese 21 Kodi i cilesise.</i></u></p> <p><u><i>http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/bordi-nderkombetar-keshillimor</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Në vitin 2013 TBU i është nënshtruar për herë të parë procesit të vlerësimit të jashtëm për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit.</p> <p>Gjatë vitit 2017 TBU i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional ku ka marrë një vlerësim pozitiv, të shoqëruar me disa rekomandime.</p> <p>Konkretisht me vendimin Nr. 104, të Bordit të Akreditimit të ASCAL, datë 10.11.2017 TBU ka marrë akreditimin institucional me kohëzgjatje 3 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 09/11/2020.</p> <p>GVJ konstatoi se nga akreditimet e mëparshme në lidhje me cilësinë, TBU ka marrë masa në plotësimin e tyre.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u></p> <p><u><i>https://ëëë.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara</i></u></p> <p><u><i>https://www.ascal.al/media/documents/rvj/IAL_38_67</i></u></p> <p><u><i>Aneksi 18 Plotesimi i rekomandimeve nga akreditimi i meparshem BscAB.</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar tek statuti dhe rregullorja përkatëse e sigurimit të cilësisë, GVJ konkludon se NJSBC paraqet qartë procedurën për sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Në fund të çdo semestri organizohet pyetësori studentor për për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. Gjithashtu realizohen studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga TBU. Vlerësimet monitoruese si rezultatet e pyetësorëve dhe studimeve gjurmuese bëhen pjesë e raporteve vjetore të TBU. GVJ vlerëson se informacioni në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurimin e cilësisë në TBU janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit (personel akademik, administrativ, si dhe studentë) të cilët bashkëpunojnë dhe janë të angazhuar për zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë dhe nxitjen e rritjes së cilësisë në të gjitha nivelet.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron se duhet hartuar një plan kalendarik ku të parashikohet plani I veprimit, në të cilin monitorimet që</i></p>




	<p>janë vlerësuar të shoqërohen me një raport me gjetjet përkatëse.</p> <p><u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final:</u> <u>: Aneksi 2 TBU Statuti (Neni 27 Pika 2-3,);</u> <u>Aneksi 8 Rregullore e NJSBC. (Neni 5, Pika 3,7-9, 11, Neni 8 Neni 10, Pika b);</u> <u>Aneksi 30 Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilesise</u> <u>Aneksi shtese 21 Kodi i cilesise.</u> <u>Aneksi 37 Raportet per monitorimin e cilesise.</u> <u>Aneksi 40 Pyetesori i studentëve.</u> <u>S.6.1 bsc ab rezultatet an ketimi.</u> <u>http://tbu.edu.al/ al/rreth-tbu/raportet-vjetore;</u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, statutin dhe rregulloret e TBU, GVJ konstatoi se monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja dhe rishikimi i programeve të studimit të ciklit të parë të realizohet nga njësia bazë përgjegjëse për secilin profil të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” në bashkëpunim me NJSBC dhe Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><u>Aneksi 2 TBU statuti. (Neni 23,27&28);</u> <u>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU. (Neni 4&5);</u> <u>Aneksi 8 Rregullore e NJSB;</u> <u>Aneksi 30 Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilesise.</u></p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të	Në takimin me drejtuesit e departamenteve dhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se në TBU përdoren procedura formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale.




<p>programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik në departament miratohen syllabuset e lëndëve/moduleve dhe reflektohen propozimet e pedagogëve për ndryshime në to bazuar në studime periodike të tregut, në propozimet e bashkëpunëtorëve dhe në komentet e të studentëve, si dhe në përputhje të plotë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Në fund të çdo semestri, organizohet pyetëtori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi si dhe pyetëtori për stafin akademik në lidhje me procesin mësimor. Gjithashtu drejtuesi i njësisë bazë përkatëse bën një vlerësim të punës të personelit të tij në fund të çdo semestri dhe në fund të çdo viti akademik. Per kryerjen e këtij vlerësimi drejtuesi i njësisë bazë mund të ndjekë orët e mësimin të personelit, të vëzhgojë disiplinën në punë dhe gjithashtu komunikimin me studentët. Vlerësimi i bëhet e ditur personelit pas kryerjes së tij.</p> <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se në nivel universiteti, NJSBC siguron procesin e vetëvlerësimit të programeve të studimit dhe institucionit.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</i></u> <u><i>Aneksi 8 Rregullore e NJSBC (Neni 7, Pika e2, Neni 8);</i></u> <u><i>Aneksi shtese 22 Plan pune 2019-2020 Dep.LP. (Pika 5);</i></u> <u><i>Aneksi 41 Pyetesor stafi akademik.</i></u> <u><i>Aneksi 11 Rregullore e punesimit. (Neni 7)</i></u></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, departamentet përkatëse përfshijnë në analizat e tyre periodike ecurinë dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor. Raporti i analizës përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Në nivel institucional, informacioni në lidhje me mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor, çështjet e evidentuara nga pyetësorët e studentëve dhe rezultatet e vizitave vlerësuese për pedagogët i komunikohen strukturave përkatëse dhe përfshihen në raportet vjetore të TBU.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p><u><i>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU. (Neni 4);</i></u> <u><i>Aneksi 38 Analize e realizimit të objektivave Programi Studimit BachelorAb 18-19.</i></u> <u><i>http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/raportet-vjetore;</i></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>




Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Në informacionin e paraqitur në RVB, NJSBC është përcaktuar si njësi që kryen monitorime periodike të programeve të studimit, kryesisht vlerësime periodike tematike. Në takimin e realizuar me përfaqësuesit e kësaj njësie GVJ konstatoi se sigurimi i cilësisë së programeve të studimit realizohet kryesisht nëpërmjet informacionit të siguruar nga anketimi i studentëve.</p> <p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</i></u> <u><i>https://tbu.edu.al/files/Relacion%20NJSBC%202018-2019</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përshkruhen parimet, procedurat dhe metodat për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Në takimin me drejtuesit e departamenteve përkatëse dhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se në TBU përdoren metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit si: analiza bazuar në tregues të matshëm cilësisë si nota mesatare në hyrje dhe dalje, kalueshmëria sipas lëndëve/moduleve, vlerësime të punës së pedagogëve për kryerjen e kontroleve në leksione, rishikime vjetore të syllabuseve, përfshirja e eksperiencave më të mira ndërkombëtare, rezultat i angazhimit të stafit akademik në projektet “exchange mobility”.</p> <p>Ndonëse në RVB nënvizohet se NJSBC kryen vlerësime për mësimdhënien, vlerësime për kurrikulën etj, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni si edhe nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të NJSBC, nuk evidentoi asnjë raport në lidhje me vlerësimet e tjera përveç pyetësorëve ndaj studentëve dhe stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo</p>	<p><u><i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i></u> <u><i>Aneksi 8 Rrregullore e NJSBC.</i></u> <u><i>Aneksi 38 Analize e realizimit të objektivave Programi Studimit BachelorAb 18-19</i></u> <u><i>http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/raportet-vjetore</i></u></p>

kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstatoi se në TBU përdoren rregullisht edhe teknikat e tërthorta të vlerësimit si pyetësorët për studentët dhe personelin akademik në vlerësimin e procesit mësimor në fund çdo semestri. ZKP organizon takime ndërmjet studentëve të diplomuar dhe studentëve aktual me qëllim njohjen mes tyre, shkëmbimin e përvojave personale dhe nxitjen e bashkëpunimit. Gjithashtu, pranë TBU është ngritur dhe rrjeti i ALUMNI, i cili synon përfshirjen e ish-studentëve në aktivitetet dhe shkëmbimin e eksperiencës në TBU.</p> <p><u>Aneksi 12 Rregullore Zyra e Karrieres TBU.</u> <u>Aneksi 40 Pyetësi i studentëve</u> <u>Aneksi 41 Pyetësori stafi akademik.</u> <u>https://tbu.edu.al/al/studentët/alumni;</u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>




<p>cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu në Rregulloren e NJSBC paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në TBU, roli dhe detyrat e strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm, inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) si dhe angazhimi i tyre si partner pjesëmarrës gjatë proceseve të sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p><u><i>Aneksi 8 Rrregullore e NJSBC. (Neni 5, Pika ,7-9, Neni 7);</i></u> <u><i>Aneksi 30 Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilesise</i></u> <u><i>Aneksi 40 Pyetesori i studentëve.</i></u> <u><i>S.6.1 bsc ab rezultatet anketimi</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, statutin dhe rregulloret e TBU, GVJ vlerëson se Institucioni garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p> <p><i>TBU RVB Programi bachelor AB final.</i> https://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/keshilli-i-etikes;</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstaton se në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit synohet edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me subjektet partnere shfrytëzohen nga strukturat përkatëse për ndarjen e mendimeve lidhur me</p>




me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit. <i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB inal.</i> <i>Aneksi 3.1 TBU Strategjia e zhvillimit 2018. (fq.7):</i> <i>Aneksi 35 Raporti periodik perfitimi marreveshje bashkepunimi.</i> <i>https://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/aktivitete-ne-tbu;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen zyrtare ëeb të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti. GVJ vlerëson se publikimet në faqen zyrtare ëeb të UBT respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final</i> <i>https://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/njsbc;</i> <i>Aneksi 2 TBU Statuti.</i> <i>https://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/dokumenta-ligjore</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, NJSBC përgatit një plan të masave nëse evidentohen mangësi apo dobësi. Rezultatet e analizës dhe plani i masave të NJSBC përfshihen në diskutimet që realizon njësia bazë përgjegjëse në lidhje me programin e studimit përkatës. Në situata të tilla, është detyrë e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit të zbatojë masat përkatëse <i>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</i>

	<u>Aneksi 2 TBU Statuti. (Neni 24, Pika 3);</u> <u>Aneksi 6 Rregullore njësisë bazë TBU.</u> <u>Aneksi 8 Rregullore e NJSBC.</u>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Edhe pse nuk konstatohet ndonjë sistem vlerësimi i posacëm për matjen e efektivitetit dhe ndikimit të këtyre veprimtarive për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, GVJ vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e stafit akademik për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në TBU, GVJ konstatoi se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me takimet periodike me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, ndonëse gjatë vizitës në institucion nuk u evidentua asnjë raport I këtij lloji. <u>Aneksi TBU RVB Programi bachelor AB final.</u>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë *Bachelor në Administrim Biznesi, me profile: a. Menaxhim; b. Marketing; c. Kontabilitet & Financë* i Institucionit të Arsimit të Lartë Tirana Business University College

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare. Fakulteti Administrim Biznesi i TBU është pjesë e pothuaj të gjithë projekteve që ka ky Institucion duke ofruar veçanërisht mundësi për mobilitet për studentët, stafin akademik dhe atë jo akademik. Kjo ndikon në rritjen e cilësisë së kurrikulës së programit, ngritjes profesionale të stafit, si dhe sigurimit të fondeve për financim.
2. Kujdesi ndaj studentit. Zyra e Këshillimit të Studentëve koordinatori i programit qëndrojnë shumë pranë tyre duke evidentuar nevojat, problematikat dhe sugjerimet për programin.
3. Harmonizimi i formimit teorik me aftësimin e njekohshëm praktik, i vlerësuar me note e kredite, e që mundëson punësimin edhe para mbarimit të ciklit bachelor, është risi që sjell TBU

Pika të dobta:

1. Literatura fizike në bibliotekën e institucionit nuk është e mjaftueshme për këtë program studimi.

Rekomandime:

1. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që IAL të pasurojë bibliotekën fizike me kopje të literaturës në funksion të programit të studimit.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program *Bachelor in Business Administration, with profiles: a. Management; b. Marketing; c. Accounting & Finance, of High Education Institution Tirana Business University College*

Strengths and affirmations

1. Participation in international projects. The Faculty of Business Administration of TBU is part of almost all projects that this Institution has, offering especially opportunities for students mobility, academic and non-academic staff. This affects the quality of the study program curriculum, the professional development of staff, and the providing funding for financing.
2. Students care. The Student Counseling Office and the program coordinator stays very close to them, identifying the needs, problems and suggestions for the program.
3. The harmonization of theoretical training with the simultaneous practical training, evaluated with grades and credits, which provides employment even before the end of the bachelor cycle, is an innovation brought by TBU.



Weaknesses

1. Hard Copy literature in the library of the institution is not enough for this study program.

Recommendations

1. The external evaluation group recommends that the HEI enrich the hard copy library with copies of the literature in function for this study program.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓	
VLERËSIMI TËRËSOR				✓	